

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7821 E premte 15 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
"1 gjithë turni i urgjencës së kë-
tushme ka qenë në kursin e gjer-
manishtes. Tani të gjithë janë në
Gjermani", thotë Filipi, që drejton
një shkollë të ...
Vijon në faqen 20

Nga DRAGOSLAV DEDOVIÇ
Edhe serbët
bëjnë gati valixhet


Opinion Ditës
Në një përpjekje për të mbledhur
sa më shumë përkrahës në pro-
testën e 16 marsit, kreu demokrat
Lulzim Basha po krijon një për-
shtypje të rreme ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Edi Rama nuk
rrezohet shpejt




Kryemadhi: 16 marsi, protesta më e fortë

Basha me artistët: Duam qeveri teknike. Diplomati gjerman: Atmosferë e helmuar

Michael Roth: Akuzat për vjedhje vote,
në institucionet e shtetit të së drejtës

Nga VALENTINA MADANI

Në tryezën e mbajtur në bashkëpunim me aleancën për mbrojtjen e teatrit "arti në mbrojtje të demokracisë", kreu i PD-së Lulzim Basha, apelojti dhe se vendi ndodhet në krizë ekonomike dhe sociale, ndërsa qeveria sipas tij është kthyer ...

Në faqet 2-3

PERGJIMET/ 12 TE ARRESTUAR, 4 NE KERKIM. PEZULLOHEN POLICE E NOTERE

SKEME PER PARA ME FAJDE, NE PRANGA GRUPI KRIMINAL

Shkodër, policia sekuestron 240 mijë euro dhe 270 mijë dollarë 'cash'. Ish-prefekti Paulin Radovani bëri denoncim, shiti pronat të paguante borxhet e fëmijëve



(Në foto) Operacioni policis Shkodër

Në faqen 6-7

MINISTRI I JASHEM

Greçia: Zgjerimi
i vijës bregdetare,
prioritet. Duam ligj të
veçantë për Himarën

Në faqen 4

LISTA E ALUZIONI

Legalizimet, 1 mijë
familjet që kanë
gati lejet në
Kamëz dhe Vorë

Në faqet 12-13

I FEJUARI I ELVANES

Vrasja në Bllok,
Ervin Mata kërkesë
prokurorisë: Dua të
flas për ngjarjen

Në faqen 8

NGA YLLI POLOVINA

Avioni bombardues
amerikan që ra në
gusht '44 dhe unaza
e vjedhur e pilotit

Në faqet 18-19

UNIVERSITETI



Konkursi në fushën
e teknologjisë, "ICT
Awards" informon
studentët e 'Luarasi'

Në faqen 9

EMRAT/ Dosjet e viteve '93-2013, kujt i njihet e drejta e kompensimit

Kompensimi, 6 mijë pronarët që marrin paratë

Agjencia e Trajtit të Pronës: Familjet që ndajnë fondin financiar

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën e 6 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të



gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të ...

Në faqet 10-11

KRIZA POLITIKE MANDATET

Zyrtari gjerman: Akuza duhet të bëhen në institucionet e shtetit të së drejtës

Roth: Bojkoti i parlamentit nga opozita është papërgjegjshmëri

"Kam frikë se atmosfera është helmuar shumë"

Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Jashtme gjermane, Michael Roth nuk pajtohet me vendimin e opozitës për të djegur mandatet dhe për të braktisur Kuvendin. Gjatë një interviste për "Deutsche Welle" duke komentuar situatën politike në Shqipëri pas takimit që pati me zëvendësministrin e Jashtëm shqiptar, Gent Cakaj, theksoi papërgjegjshmëri bojkotin e opozitës.

Ministër i Shtetit Roth, ju u takuam për herë të parë me z. Cakaj, në rolin e tij si ministër i jashtëm i Shqipërisë në detyrë. Cilat ishin përshlytyjet tuaja?

Pitova një përshlytje pozitive për kolegun e ri. Ai është një politikan shumë profesional dhe shumë kompetent në biseda. Bëra të qartë edhe një herë se edhe ne i vlerësojmë përpjekjet e deritanishme për reforma. Sidomos në reformën e gjyqësorit. Vetingu është një model unik për pastrimin e tërë sistemit të drejtësisë nga korrupsioni. Bëra edhe njëherë të qartë se nevojiten reforma të mëtejshme, në veçanti në luftën kundër korrupsionit dhe në luftën kundër krimit të organizuar. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që reformat duhet t'i komunikohen mirë publikut evropian. Folëm edhe për politikën e brendshme. Polarizimi ndërmjet opozitës dhe qeverisë nuk është një fenomen shqiptar, por e konstatojmë me keqardhje edhe në shumë vende të tjera në tranzicion. E konsiderojmë të papërgjegjshëm bojkotin e parlamentit nga partitë opozitare. Sepse nuk është vetëm bojkot kundër parlamentit ose i qeverisë, por edhe ndaj demokracisë. Parlamenti është vendi, ku duhet bërë debati. Kam frikë se atmosfera është helmuar aq shumë sa që nuk do të ketë më dialog mes partive të opozitës dhe qeverisë, edhe pse ky dialog është shumë i nevojshëm. Biseduam edhe për normalizimin e marrëdhënieve Serbi-Kosovë, dhe e bëra edhe njëherë të qartë se Qeveria Federale e hedh poshtë mundësinë e shkëmbimeve territoriale si një option tejet të rrezikshëm.

Opozita akuzon qeverinë se i ka blerë votat në zgjedhjet e mëparshme, prandaj e quan parlamentin jolegitim. Cili është qëndrimi juaj këtu?

Akuza duhet të bëhen me anë të institucioneve të shtetit të së drejtës. Si mund të bëhen ndryshe? Shteti i së drejtës nuk mund të anashkalohet duke ndaluar punën në parlament. Demokracia nuk funksionon në këtë



Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Jashtme gjermane, Michael Roth

STATUSI

Jo, këtë nuk e kam dëgjuar ende. Por këtu procedura është shumë e qartë: raporti i progresit të Komisionit Evropian do të publikohet më 29 maj. Vitin e kaluar, në qershor, ne e shqyrtuam çështjen e anëtarësimit në BE me shumë dashamirësi si për Shqipërinë edhe për Maqedoninë e Veriut. Por nuk do të ketë automatizma.

Tryeza "Arti në mbrojtje të demokracisë"



Shteron lista e PD-së në Kukës, bllokohet plotësimi i vakancave

Procesi i zëvendësimit të mandateve të deputetëve të partive opozitare fundet në ngërç. Kjo për shkak të shterimit të listave të kandidatëve të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. I pari qark ku ky fenomen është hasur është ai i Kukësit. Kjo pasi KQZ e ka të pamundur të zëvendësojë mandatin e lënë nga deputeti i PD-së, Isuf Cela, pasi kandidati i fundit në listën e PD-së për këtë qark Miftar Dauti nuk ka pranuar ta marrë mandatin. Pas Kukësit e njëjta situatë pritet të përsëritet në Gjirokastrë e më pas edhe në qarqe të tjera. Kjo ka vënë KQZ-së para një dileme të vështirë, nëse duhet të vijojë të bëjë plotësimin e vendeve vakante me kandidatë nga listat e



partive të tjera apo duhet ta stopojë procesin me shterimin e listës së partisë që i përket mandati i deputetit, në rastin konkret të PD-së. Ekspertët janë thuar se në një mendje sa i përket faktit se Kodi Zgjedhor nuk jep zgjidhje për këtë. Për Krista Kumen Kodi nuk jep zgjidhje dhe KQZ nuk duhet të vijojë më tej me plotësimin e vendeve vakante me listat e

partive të tjera. "Kodi Zgjedhor nuk jep përgjigje për një situatë të tillë. Për mendimin tim në një rast të tillë procesi i plotësimit të vakancave përfundon. Ato nuk plotësohen nga kandidatë të listës të partive të tjera", shpreh Kume. Ndërkohë që edhe burime nga KQZ bëjnë me dije se pasi shteron lista e partisë politike që ka të drejtën e mandati "hesh" dhe nuk jep zgjidhje si vepohet. Sipas tyre çdo zgjidhje tjetër për plotësimin e mandateve do të vinte si rrjedhojë e një interpretimi, por joshprehje e qartë e Kodit. Po ashtu edhe nga PS bëhet me dije se ky proces ndalon në momentin e shterimit të listës. Po ashtu nga PS mësohet se për rrjedhojë kjo forcë nuk do të pranjojë të marrë mandatet e partive të tjera.

mënyrë.

A e rrezikon gjendja aktuale në Shqipëri çeljen e negociatave me të anëtarësimit në BE?

Unë do të dëshiroja që, edhe nëse grindja është nevojshme, të mos dilet nga tema. Debati është eliksir i një demokracie të gjallë. Por është e rëndësishme që të ketë mirëkuptim thelbësor në disa

çështje, pavarësisht se kush është në opozitë e kush në qeveri. Aty përfshihen çështjet kushtetuese, çështjet zgjedhore dhe për mua, çështjet e afrit me BE. Këto çështje duhet të mbështeten nga një konsensus i gjerë politik. Dhe sigurisht, konfliktet të tilla kanë një efekt paralizues, sepse ato, gjithashtu, prodhojnë tituj negativë në media.

Nga ana tjetër, reformat mund të fillojnë vetëm nëse vendosen në parlament.

Qarkullojnë fjalë se Maqedonia e Veriut mund ta merret dritën jeshile për bisedimet, por jo Shqipëria. I keni dëgjuar edhe ju këto përsiatje?

Jo, këtë nuk e kam dëgjuar ende. Por këtu procedura është shumë e qartë: raporti i pro-

Besnik Bare: Opozita kërkon ta çojë vendin në destabilitet

Iftuar ne rubrikën 'Opinion' në News24, deputeti PS, Besnik Baraj u shpreh se opozita nuk e ka popullin me vete dhe se nëpërmjet lënies së mandateve dhe protestave kërkon destabilitetin e vendit. "Opozita pretendon se ka popullin, por nuk ka as njerëzit që kishte futur në listat për deputetë. Lufta që po bëjnë opozita është jo reale, por efektive. Nuk ka mësuës sot që shkojnë në manifestime politike të qeverisë. Kur ishte opozita në pushtet nëse bëjmë një krahasim ka ndryshim shumë të madh. Populli nuk është mburra opozitës. Në njësitë bashkiake që drejtohen nga opozita ditën që ka protesta nuk gjen asnjë në punë. Rudina Hajdari është këshilluar me institucione ndërkombëtare dhe ka vepruar për mandatin. Ata duan ta çojnë vendin në destabilitet dhe t'i vënë zjarrin parlamentit. SHBA dhe BE e shohin veprimin e opozitës si çmenduri", tha deputeti i PS. I pyetur se pse nuk hetohet kreu i bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako për akuzat e blerjes së votave, deputeti i PS tha se këtë duhet ta bëjë drejtësia dhe sipas tij Basha dhe Berisha kërkojnë të pengojnë sistemin e ri të drejtësisë.

Massafra: I lutem Zotit t'i ndryshojë mendjen politikanëve

Arqipeshkvi i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra i ka bërë një tjetër apel politikës shqiptare që të gjejë një zgjidhje për situatën që po kalon vendi pas largimit të PD-së dhe LSI-së nga parlamenti dhe protestave. "Më lejoni ta aktualizoj. Kemi shumë nevojë në këtë kohë që të përjetojmë gëzimin, sepse problemet janë të mëdha. Edhe lusim Zotin që t'u ndryshojë mendjen atyre që kanë çështjet në dorë të shoqërisë civile dhe politike në Shqipëri duke u ndihmuar edhe nga ndërkombëtarët të arrijnë në një konsensus për të kapërcyer problemet që kemi sot. Sepse përndryshe edhe kjo nxitje do jetë e kotë. Të gjithë të angazhohemi që në çdo zemër të mbretërojë gëzimi dhe galdimi"-tha ai.

Pra, gjithçka është e hapur?

Gjithçka është e hapur. Është ende në proces. Në muajt e ardhshëm mund të vazhdohet me reforma të rëndësishme. Sa më shumë reforma që të ketë në muajt e ardhshëm dhe sa më shumë parti të marrin pjesë në to, aq më e dobishme është kjo për vendimin pozitiv.



Tryeza, Dizdari: Lënia e mandateve, gjest i madh, por i gjori ju, kryetar, ç'do hiqni

Kriza, Basha: Qeveri teknike për një demokraci funksionale

Kapexhiu: Rama duhet të ikë. Tupja: Është diktator

Valentina Madani

Në tryezën e mbajtur në bashkëpunim me aleancën për mbrojtjen e teatrit "arti në mbrojtje të demokracisë", kreu i PD-së Lulzim Basha, apeloj dje se vendi ndodhet në krizë ekonomike dhe sociale, ndërsa qeveria sipas tij është kthyer në bandë që grabit gjithçka. Protestën e artistëve dhe shoqërisë civile kundër shembjes së Teatrit Kombëtar, Basha e shikon si frymëzuese për shembjen e qeverisë Rama. Para tyre z.Basha tregoi planin e tij për t'i dhënë vendit një demokraci funksionale, që sipas tij nis me një qeveri tranzitore. "Të gjithë jemi të vetëdijshëm, unë jam i vetëdijshëm që vendi ndodhet në një krizë të thellë ekonomike, sociale dhe pa dyshim edhe politike, e cila e ka shtyrë dhe opozitën drejt një vendimi të paprecedent, por plotësisht legjitim, moral, politik dhe kurajoz. Atë të largimit nga një parlament i faktuar si produkt jo i votës së qytetarëve, por bashkëpunimit sistematik dhe të shtrirë në territorin e vendit, mes kupolës drejtuese të një partie politike dhe kupolës drejtuese të kimit të organizuar në Shqipëri. Në vlerësimin tonë kriza politike kërkon një zgjidhje akute, e cila mund të kalojë vetëm përmes kthimit të vullnetit të popullit, kthimit të zgjidhjes tek populli me zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe natyrisht hedhjes së një sërë hapsh paraprakë në këtë drejtim. Së pari, krijimin e një qeverie tranzitore pa njërin përgjegjës për asgjësimin e procesit zgjedhor dhe proceseve politike dhe për kthimin e qeverisë dhe shtetit në një bandë që i shërben interesave të disa bandave". - theksoi z.Basha. Para artistëve dhe përfaqësues të shoqërisë civile Basha foli dhe për lënia e mandateve. Djegia e mandateve, sipas tij, ishte hapi i parë për t'iu përgjigjur thirrjes së qytetarëve që kërkojnë rrezimin e qeverisë. "Pala tjetër do ta shesë si përplasje, por nuk është e tillë, është kauzë jetike dhe hapi që kemi bërë në është për t'iu rreshtuar krahu njerëzve", u shpreh kreu i opozitës.

ISH-THEMELUESI
Në tryezë, mes të panishme ishte dhe ish-themeluesi i PS-së, kompozitori Limoz Dizdari, i cili solli në vëmendje bashkëbisedimin me Edi Ramën, kur drejtonte Minis-



Kreu i PD-së Lulzim Basha, dje me artistët

Kryemadhi: Protesta e 16 marsit ndër më të fortat që ka parë vendi

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi takoi dje shetëtabet në Tiranë, nga ku theksoi se vendimi i opozitës. Kryemadhi u shpreh se ndihet i aftë të krijojë një krenarie e Kryemadhi dhe LSI-së. Ne jemi të bindur që ju kemi bërë veprimin e duhur, ndonëse është veprim ekstrem", u shpreh Kryemadhi. Ajo ftoi qytetarët që të marrin pjesë në protestën e paralajmëruar të 16 marsit, për të cilën u shpreh se do të jetë protesta më e madhe që ka parë vendi që pas rrëzimit të bustit. "Në protestën e ditës së shtunë do të dali i gjithë populli. Do dali sepse kjo është qeveria që vjedh popullin. Shumë shpejt do të shkojmë në zgjedhje të parakohshme, që do ndërtojnë sistemin e barabartë të institucioneve dhe atë që ne kemi kërkuar, lirinë e mirëfilltë. Ftojini qytetarët të jenë në protestë, sepse do të jetë një protestë shumë e bukur do jetë një nga protestat më të forta që ka parë Shqipëri e tranzicionit pas rrëzimit të bustit", u shpreh Kryemadhi.



trinë e Kulturës, që ashtu si sot kërkonte ndërtime dhe një teatri të ri. Ai e quajti nismën e Bashës si një fillim të mbarë. Por Dizdari nuk i kurseu shqetësimet për opozitën, ndërsa tha se shumë oligarkë kanë dalë edhe nga ky krah. "I gjori ju zoti Basha çdo të hiqni. Vërtet që kini probleme shumë të mëdha, por është fillim i mbarë që kërkoni mendimin krijues. Unë vij me kënaqësi tek ju jo për ta sharë qeverinë, por për të thënë të vërtetat që ajo çfarë është dhe ne nuk e ndryshojmë, por

mollët e këqija duhen hequr dhe ato që sapo kanë filluar të prishen duhen pastruar", tha z.Dizdari. E quajti gjest të madh heqjen dorë nga mandati por nuk mori përgjigje nga Basha se perse të huajt ishin kundërshtarë të këtij gjesti. "Ju kemi bërë një gjest shumë të madh. Tërhoqet të gjithë deputetët. Është një masë të cilën unë si Limoz për aq sa jam në dijeni të politikës dhe vlerave që mbarb them se ishte gjëja më e domosdoshme dhe nuk kishit mundësi të tjera. Por nuk i

jap dot përgjigje pyetjes pse të huajt janë kaq kundërshtarë ndaj këtij gjesti. Unë jo se nuk e marr me mend, por kërkon argument institucional. Ku e gjen forcën individit goftë dhe kryeministri të jetë kaq kokëfortë e ekzigtent dhe si nuk e sheh realitetin nësoj siç e shoh unë dhe shqiptarët", u shpreh z.Dizdari.

RRËZIMI
Profesor Edmond Tupja dhe karikaturisti Bujar Kapexhiu ishin më të drejtpërdrejtë teksa folën për mënyrën që duhen ndjekur për rrezimin e qeverisë Rama. "Në mendjen e çdo qytetari sot duhet të ekzistojë vetëm një slogan. Dhe unë do ta shpigoj me krijimin tim të fundit që ka dalë në gazetë. Ndoshta është në Elbasan, dy qytetarë një burrë e një grua që mbajnë tepsitë me ballokume dhe mes të dyve është Edi Rama që i shikon i çuditur, sepse mes ballokumeve ata të dy kanë nga një tabelë Rama ik. Nëse të gjithë qytetarët që shesin ballokume në rrugën e gjatë të Elbasanit do të kishin Rama ik do të ishte shumë filmike. Duhet të ekzistojë. Nëse ikën, ikën dhe rreziku për gjithçka. Nëse të gjithë brenda vetes tonë të shohim Rama ik! Ikën rreziku ikin të gjitha dhe nuk prishet asgjë vetëm ndërtohet", tha z.Kapexhiu. Shkrimtari Edmond Tupja, e cilësoi Ramën diktator që ka frikë nga teatri. "Qeveria aktuale me kryeministrin ka frikë nga teatri, të gjithë diktatorët kanë frikë nga teatri kur ai nuk u shërben interesave të tyre sepse në teatër spektatori bën katarsis. zhvishet. Dhe të zhvishesh do të thotë të shikosh veten lakuriq. Të zhvishesh lakuriq do të thotë të shikosh sa vlen dhe kur ti e kupton se nuk vlen urren vetveten dhe kërkon të shërohet nga vetvetja. Kjo është për zotin Rama", tha z.Tupja.

DEKLARATA

"Sot Teatri po prishet. Por më duket, këta oligarkët kanë mbirë nga database juaj. Ka shumë oligarkë, por nga ky database kanë dalë. Kështu, i nderuar z.kryetar i opozitës, hallet tuaja janë shumë të mëdha, nuk e di si do ta përballoni por rruga që keni nisur është e madhe. Duhet ta pranojmë që jemi pak dembelë, shpërdorues të kohës", - tha z.Dizdari.

SHKURTE

PD, Bardhi: DASH konfirmon blerjen e votave

Sekretari i Përgjithshëm i PD-së Gazment Bardhi deklaroi dje se DASH konfirmon blerjen e votave në 2017 dhe nivelin e lartë të korrupsionit. Por sipas tij, askush nuk ndëshkohet. "Raporti i DASH konfirmon blerjen e votave në 2017 dhe nivelin e lartë të korrupsionit të qeverisë 'Rama'. Askush nuk ndëshkohet! Kundër blerjes së votave, kundër pandëshkuemërisë, kundër korrupsionit, shqiptarët do bashkohen më 16 mars!", tha Bardhi. Ai citon DASH: "Ligji parashikon ndëshkime penale për korrupsion për zyrtarët publikë, por qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive dhe zyrtarët shpesh u angazhuan në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha degët e qeverisë".

Hajdari me Shütz: Nuk mund të rrimë duarkryq

Deputetja Rudina Hajdari takoi dje ambasadorin gjerman në Tiranë, Sussane Shütz, me të cilën sipas saj, diskutoi për "situatën e vështirë dhe shumë delikate në të cilën ndodhet vendi". Ajo shprehet se dorëzimi i mandateve nga opozita nuk është zgjidhje. "Dorëzimi në bllok i mandateve nga ana e opozitës nuk është zgjidhje, ashtu siç nuk është aspak zgjidhje arroganca qeveritare. Sjellja e politikës Shqiptare sot është modeli më i keq i mundshëm që po i ofrojmë qytetarëve Shqiptarë dhe sidomos të rinjë. Nuk mund të rrimë duar-kryq dhe të presim që ky ngërç i paprecedent politik-institucional të zgjidhet vetë. Situata mund të agravojë kur aktorët nuk vlerësojnë siç duhet rrethanat", - tha zj.Hajdari.

Mustafaj: Rudinës, prej moshës i lejohen gabimet

Për ish-ministrin Besnik Mustafaj është jetike në demokraci mbushja e rrugëve me njerëz që kërkojnë përmirësimin e sjelljeve të një qeverie. Ai pohoi dje në News 24 se kryeministri Edi Rama nuk arrin të lexojë pakënaqësitë e qytetarëve dhe kjo në pikëpamjen e Mustafajit është e rrezikshme për një sistem demokratik. Ish-diplomati, foli edhe për vazhën e Azem Hajdarit, e cila nuk shkoi në një linjë me PD-në për të djegur mandatin e deputetes. "Nuk preferoj të bëj koment për Rudinën. Është në një moshë që po rritet dhe po piqet. Mbiemri Hajdari është shumë i rëndësishëm. Hajdari është në momentin dhe në moshën që i lejohen gabimet dhe ato janë elementë të mësimi", -tha z.Mustafaj.

Qeveria ka publikuar notat e qytetarëve për secilin dikaster

Notat për ministrinë për 2018-ën, Majko e Bushati marrin 10, Gjonaj 2

Qeveria ka publikuar notat që qytetarët u kanë vendosur ministrave dhe asaj vetë për shërbimet e ofruara dhe problemet e zgjidhura. Raporti është publikuar në faqen e Kryeministrit dhe të dhënat janë për periudhën janar-dhjetor 2018. Pra, kemi të bëjmë me vlerësimin që qytetarët kanë dhënë për secilin prej ministrave dhe vetë qeverinë përpara se ajo të përfshihej në ndryshimet e këtij fillimviti. Thënë ndryshe, notat që kanë vendosur qytetarët nuk janë për ministrat e

rinj. Sipas raportit të publikuar Ministria e Jashtme e drejtuar nga Dimitri Bushati ka vlerësimin më të lartë nga qytetarët. Kjo ministri është vlerësuar me 10. Por, duhet theksuar fakti që për të kanë dhënë vlerësimin e tyre një numër shumë i vogël qytetarësh, vetëm 3. Me 10 është vlerësuar edhe Ministria për

Diasporën, e drejtuar nga Pandeli Majko. Edhe në këtë rast, vlerësimi mund të mos jetë plotësisht i merituar, pasi për këtë ministri ka shprehur vlerësimin vetëm 1 qytetar. Vlerësimin e tretë më të mirë e ka Ministria e Mbrojtjes e drejtuar nga Olta Xhaçka. Por, ashtu si në dy rastet e mëparshme, edhe

për këtë vlerësimi është bërë nga një numër shumë i vogël qytetarësh, vetëm 3. Një vlerësim të mirë, mbi 6 kanë marrë Ministria e Brendshme, ajo e Bujqësisë, Arsimit dhe Shëndetësisë. Ndërkohë që vlerësimin më të dobët qytetarët kanë dhënë për Ministrinë e Drejtësisë. Metatarja e vlerësimit të dhënë

INSTITUCIONI	184	6.5
KRYEMINISTRIA	21	6.5
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISE	15	6.4
MINISTRIA E BRENDSHME	10	6.1
MINISTRIA E BULGËRIKË DHE SHQIPTARË BUNAL	7	6.1
MINISTRIA E DREJTËSISË	45	2.6
MINISTRIA PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME	3	10.0
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN	1	10.0
MINISTRIA E FINANÇAVE DHE BUDZHETIT	15	6.3
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERJES	20	5.6
MINISTRIA E MBRROJTJES	3	9.7
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBRROJTJES SOCIALE	21	7.0
MINISTRIA E TËRHEQJES DHE MARRËS	3	3.3

nga 45 qytetarë ka qenë vetëm 2.6, pra notë ngelëse. Po ashtu, notë ngelëse ka marrë edhe Ministria e Mjedisit, që është vlerësuar me 3.3. Ndërkohë që vetë qeveria ka marrë notën 6.5. Por, pa-

varësisht vlerësimit të dhënë nga qytetarët, kryeministri nuk i ka marrë fare parasysh këto vlerësime në rastin e bërjes së ndryshimeve në qeverinë fillim të këtij viti.

Ministri grek thekoi se është prioritet i qeverisë greke zgjerimi i vijës bregdetare

Greqia kërkon ligj të veçantë për pronat e Himarës dhe minoritetin

"Marrim parasysh trazirat politike në vendin fqinj"

Qëndrueshmëria e pronave të Himarës dhe ajo e regjistrimit të minoritetit grek në Shqipëri do zgjidhen nëpërmjet ligjeve të veçanta. Këtë e ka bërë të ditur ministri i Jashtëm (plotësues) grek, Jorgos Katrugalos gjatë një interviste për radiostacionin grek "Real Fm" dhënë për gazetarin Nikos Haxhinikolau. Duke folur dhe për ecurinë e marrëdhënieve bilaterale me Shqipërinë, gjatë bisedës, gazetari është interesuar për vonesat e vijimit të negociatave mes dy vendeve për zgjidhjen e çështjeve të mbartura prej vitesh dhe që shpesh herë kanë krijuar tension dhe mosmarrëveshje. Ministri grek është përgjigjur se vonesat vijnë për shkak të trazirave politike në Shqipëri, por dhe për mungesën e përgjigjeve të dhëna nga pala shqiptare për minoritetin grek. Dhe këtu, ai parashtrroi për herë të parë në opinion publike idenë e një ligji të posaçëm që të trajtojë çështjen e pronave të banorëve të Himarës dhe të një ligji tjetër që të përcaktojë qartë që regjistrimi i minoritetit grek të bëhet mbi bazën e deklaratave të vet qytetarëve. "Është e drejtë vërejtja për sa i përket vonesës në negociata, ka arsye, ne padyshim që marrim parasysh trazirat politike në vendin fqinj. Ndërkohë që duhet të marrim dhe përgjigje për çështjet e parashtruara dhe madhore të minoritetit grek: konkretisht janë dy ligje që referohen në të drejtat përkatëse, ligji për mbrojtjen e pasurisë së palëvizshme në bregun e Himarës, si dhe ligji i përcaktimit të identitetit, që ofron mundësinë e deklarimit si minoritar në procesin e regjistrimit", - tha Katrugalos. Jo vetëm kaq, por ai bëri të ditur se lidhur me këto çështje janë dhëna disa përgjigje nga pala shqiptare, por pa bërë të ditur nëse ajo ka pranuar apo jo që ti trajtojë këto dy çështje me ligje të veçanta dhe dukshëm favorisues në favor të interesave greke në vendin tonë. "Janë dhënë disa përgjigje nga pala shqiptare, në një farë mënyre mund të them se kanë rriffullar diskutimet, por është akoma tepër herët të parashikojmë rezultatit. Megjithatë, theksoj sërish se vullneti ynë është ecuria dhe




Ministri i Jashtëm (plotësues) grek, Jorgos Katrugalos

përmirësimi i çështjeve bilaterale, e përmes këtij përmirësimi të lirohet dhe rruga evropiane për Shqipërinë", - shtoi më tej ministri Katrugalos. Në lidhje me deklaratat e mëparshme të qeverisë greke, përfshi dhe të

ish-ministrit Nikos Kotzias, për vijën bregdetare dhe zonën ekskluzive ekonomike, ministri Jorgos Katrugalos bëri të ditur se është në prioritetet e qeverisë greke zgjerimi i vijës bregdetare greke. "Zgjerimi i vijës breg-

detare dhe përcaktimi i zonës ekskluzive ekonomike është ndër prioritetet e kryeministrit Cipras. Madje, zgjerimi i vijës bregdetare përfshihet në projektin e përcaktimit të Zonës Ekskluzive Ekonomike me Shqipërinë, Italinë dhe Egjiptin, ky i fundit nëse realizohen negociatat e duhura. Bëhet fjalë për një vendim politik që sipas kryeministrit do të mbyllet me miratimin e legjislaturës përkatëse", - tha më tej ai. Ministri i Jashtëm i Greqisë, gjithsesi, nuk ka përcaktuar afatit kohor të negociatave për paketën e çështjeve me Shqipërinë, që sipas tij janë në varësi të plotë të vendimeve për shëllfin detar. Por ka theksuar se përbëjnë një prioritet për Greqinë dhe jo thekshat deklarata impresionuese kalimtare.



Presidenti Meta në Baku: Kërcënime terroriste po përhapen me shpejtësi

Presidenti Ilir Meta shprehu dje domosdoshmërinë e ndërlikohjes së rajoneve, në kushtet kur sipas tij bota sot po përballlet me sfida të panjohura më parë. Kreu i Shtetit theksoi se sfida të tilla si, siguria globale, multilateralizmi, ndryshimet klimatike, migracionin, lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm po dominojnë politikën e jashtme. I ftuar në Forumin e 7-të Global të Bakusë, me temë: "Një Politikë e Jashtme e Re", kreu i shtetit shqiptar tha se kërcënimet terroriste, ndryshimet klimatike dhe faktorët të tjerë po cenojnë jo pak paqen në arenën ndërkombëtare. "Kërcënime të reja nga terrorizmi ndërkombëtar po përhapen me të njëjtën shpejtësi si revolucioni teknologjik dhe siguria kibernetike po bëhet një sfidë e madhe për shoqëritë dhe vlerat tona. Në rrethana të tilla, duhet të përqijemi shumë për të ndërlidhur vendet dhe rajonet tona në mënyrë që të tejkalohen me sukses këto sfida si dhe të rriten aftësitë tona të sigurisë e të përmirësojmë lidhjen tonë energjetike dhe infrastruktururore", deklaroi z.Meta. Presidenti u shpreh se, Shqipëria është shumë e angazhuar për bashkëpunimin rajonal dhe për forcimin e mëtejshëm të multilateralizmit. Duke folur për sfidat e Ballkanit Perëndimor, Meta vuri theksin tek domosdoshmëria e dialogut Kosovë-Serbi, ndërsa evidentojti edhe përparimet e Shqipërisë drejt BE.

EMBASSY OF THE STATE OF QATAR

NJOFTIM PUNËSIMI

AMBASADA E SHTETIT TË KATARIT NË TIRANË KËRCON TË PUNËSOJË:

- Sekretare ekzekutive
- Përkthyes të gjuhës arabe
- Hulumtuës ekonomik

Kriteret:

- Sekretarja ekzekutive duhet të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze dhe përvojë në administrim zyre.
- Përkthyesi të jetë specializuar në këtë fushë dhe të ketë njohuri të shkëlqyera të gjuhës arabe.
- Hulumtuësi ekonomik të ketë formim arsimor në ekonomi dhe përvojë profesionale në fushën e tij
- Njohjen e gjuhës arabe dhe angleze.

Kritere të përbashkëta:

- Eksperiencë në pozicionin e kërkuar,
- Shkolla e lartë e sipër
- Të jenë të motivuar
- Të artikulojnë dhe në lartësinë e detyrave që iu ngarkohen,
- Njohje e programeve bazë kompjuterike.

Posta elektronike për dorëzimin e aplikimit
(e-mail): hr_embassyqatar@yahoo.com, Tel: +355(4)2274579

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Baillif Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 08.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 45.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1+25, Vol.13, Fq.41, Zk.3076 në pronësi të Hipotekës së shtetit, Sina Konstruktion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 9,132.48 (Nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e dy pika dyzet e tetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 63.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28+1+26, Vol.13, Fq.42, Zk.3976 në pronësi të Hipotekës së shtetit, Sina Konstruktion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 12,761.28 (Dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pika njëzet e tetë) Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

Huamarrja rritet me 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë

Kredia konsumatore arriti në 47.4 miliardë lekë në fund të 2018-ës

Raporti i Bankës së Shqipërisë, paratë për blerjen e aktiveve qarkulluese

Kredia konsumatore u rrit me 8% gjatë vitit 2018. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, portofoli i kredisë konsumatore dhënë nga sistemi financiar arriti në 47.4 miliardë lekë, ose rreth 380 milionë euro. Sipas të dhënave të Bakës së Shqipërisë, mësohet se rritja më e lartë ka ardhur në segmentin e kredisë së mirëfilltë konsumatore, të akorduar për blerjen e mallrave jo të qëndrueshëm. Në fundin e vitit të kaluar, portofoli i kredisë bankare për këtë qëllim arriti në 27.8 miliardë lekë, me një rritje prej afro 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në rritje, por me ritëm më të ngadaltë është kredia për mallra të qëndrueshëm, që arriti në 19.6 miliardë lekë, 3.7% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2017. Kredia për blerjen e mallrave të qëndrueshëm u referohet kryesisht blerjeve në vlerë të mëdha, siç mund të jenë automjetet, pajisjet elektronike dhe elektroshtëpiake apo mobiliet. Analizat e Bankës së Shqipërisë vendosin përtëritjen e konsumit të sektorit privat, si faktori më përcaktues për rritjen ekonomike. Sipas INSTAT, norma e rritjes vjetore të konsumit për 9-mujorin 2018 ishte 3.4%, statistikat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se kredia konsumatore është një nga faktorët që po mbështesin gjallërimin e konsumit privat në vend.

ÇLIRIMI I KREDITIMIT
Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i bëri thirrje sistemit bankar të gjejë rrugë për të rritur kreditimin e ekonomisë. Pak kohë më parë,



Banka e Shqipërisë

Sejko tha se, edhe duke mirëkuptuar problemet nga ana e kërkesës, huadhënia është shumë larg potencialëve. Në fund të muajit tetor të vitit të shkruar, portofoli i kredisë për ekonominë ishte në rënje me mbi 20 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Sipas tij, rritja e qëndrueshme ekonomike e vendit nuk është e mundur pa rigjallërimin e kredisë bankare. Sipas tij, sektori bankar ruan kursimet e sh-

qiptarëve dhe ka për detyrë që këto kurse t'i vendosë në dispozicion të rritjes dhe të zhvillimit të vendit. Ai kërkoi nga bankat propozime konkrete për masa që do të mund të kontribuonin në rritjen e kreditimit dhe shtoi se Banka e Shqipërisë do të jetë gjithmonë mbështetëse e këtyre nismave. Sipas bankës qendrore, rritja e konsumit është mbështetur gjithashtu nga rritja e punësimit dhe të ardhurave

nga puna, si edhe përmirësimi i besimit të konsumatorëve.

STRATEGJIA

Banka e Shqipërisë ka renditur si një ndër projektet afatmesme reduktimin e mëtejshëm i stokut të kredive me probleme. Gjatë periudhës afatmesme në vijim, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë do të konsistojë në drejtim të: zbatimit të plotë të masave të parashikuara në Planin Kombëtar për Kreditë e Këqija, monitorimit të kujdesshëm të praktikave të bankave për krijimin e fondeve rezervë për humbjet nga kreditë, zhvillimit të tregut për shitjen e kredive me probleme, nxitjes së bankave drejt zbatimit të planeve të rimëkëmbjes së kredimarrësve të mëdhenj dhe orientimit të kredisë së re në sektorë të shëndetshëm të ekonomisë.

APP "disiplinon" kompanitë:

Deklaratë për ofertë të pavarur

Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar një vendim, që detyron operatorët ekonomikë të plotësojnë "Deklaratën për paraqitje ofertë të pavarur", duke synuar ndalimin e marrëveshjeve paraprake mes kompanive që marrin pjesë në tenderë. Përfshirja e këtij dokumenti ka ardhur pas një bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, të cilit i është kërkuar mendim mbi këtë problematikë të ndeshur gjatë procesit të prokurimit. Sipas Agjencisë, është pikërisht Autoriteti i Konkurrencës që ka propozuar përfshirjen e kësaj deklarate në dokumentet standarde të tenderit për punë, mallra dhe shërbime, me qëllim ndalimin e marrëveshjeve në oferta ndërmjet operatorëve ekonomikë, në formën e konsultimeve, komunikimeve apo marrëveshjeve me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të vecanta të produkteve apo shërbimeve, të cilat lidhen me një procedurë prokurimi. Në jo pak raste operatorët ekonomikë bëjnë marrëveshjeve të fshehta mes tyre, duke rritur vlerat e ofertave apo ulur cilësinë e produkteve të ofruara, duke sjellë edhe dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 9 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përkthimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10, 1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Hapet njëra anë e autostradës

Balluku: Tiranë-Elbasan përfundon më 17 maj, brenda afatit të vendosur

Dje është hapur njëra anë e autostradës Tiranë-Elbasan për të gjithë kalimin e automjeteve edhe në pjesën e mbetur nga TEG-u deri te tuneli në Ibë. Ndërsa deklaroi se janë përfunduar rreth 95.3% e punimeve në këtë aks rrugor, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, gjatë inspektimeve të kantierit të punimeve tha se siç ishte parashikuar edhe më herët, pritet të hapet brenda afatit të vendosur, më datë 17 maj. Ndërkohë, ka shtuar më tej se karexhata e hapur është pajisur me të gjithë sinjalistikën e nevojshme. "Tashmë janë përfunduar 95.3% e të gjitha punimeve. Pjesa e mbetur, siç folëm edhe me kompaninë do të dorëzohet sipas afatit të vendosur më 17 maj, që është pjesa e segmentit të fundit nga 12.8 km që hapën", -tha Balluku. Të



Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

paranishëm në inspektimin e punimeve ishin edhe kryeministri Edi Rama si dhe ministrja e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato, e cila konfirmoi edhe një herë hapjen e karexhatës tjetër të këtij aksi në maj të këtij viti. "Këtu janë hapur të dyja kor-

sitë për qarkullimin. Vetëm nga kthesa e Ibës deri në tunel përdorim vetëm karexhatën e majtë me dy kalime, derisa në 17 maj të përfundohen dhe punimet për të hapur dhe këtë karexhatë që jemi duke përkthuar tani", -tha Qato.

OPERACIONI NE SHKODER DENONCIMI

Denoncimi fundosi grupin, Radovani ka marrë statusin e dëshmitarit të mbrojtur

Djemtë të varur nga kazinotë, ish-prefekti denoncoi skemën e fajdexhinjëve

Paulin Radovani u detyrua të shiste pronat për të paguar borxhin, fëmijët u arratisën jashtë vendit

SHKODËR

Pak orë pas arrestimit të 12 personave si dhe shpalljen në kërkim të 4 të tjerëve janë zbardhur detaje të reja në lidhje me operacionin e koduar "Maranaj". Burime zyrtare nga prokuroria e Shkodrës dje bënë me dije se rrjeti kriminal u zbulua pas një denoncimi të bërë nga ish-prefekti i qarkut Shkodër, Paulin Radovani si dhe ish-këshilltar në këshillin bashkiak të Shkodrës. Paulin Radovani ishte për shumë vite me radhë edhe një biznesmen i njohur në Shkodër, sipërmarrës në fushën e fasonerisë. Në gjithë këto vite erdhi duke forcuruar biznesin e tij, derisa prej 2-3 vitesh nisi një histori e paparashikuar. Dy djemtë e tij, njëri prej të cilëve anëtar në këshillin aktual të bashkisë Shkodër, Elton Radovani si shkak i bixhozit dhe varësisë ndaj kazinove nisi duke marrë hua shumta të mëdha parash tek persona të ndryshëm në Shkodër, të cilët ia lëshonin me një përqindje që varion nga 3-20%. Këto fajde bënë që ish-prefekti të nisë dhe të shesë disa prej pronave të tij. Disa i shiti brenda një kohe të shpejtë, ndërsa disa prona të tjera ia morën fajdexhinjtë duke qenë se nuk kishte shlyer tek



Ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani

DENONCIMI DHE HETIMI

Dy djemtë e ish-prefektit kohët e fundit janë arratisur jashtë Shqipërisë për t'i shpëtuar përndjekjes nga fajdexhinjtë, ndërsa vetë ish-prefekti mësohet se ndodhet ende në Shkodër. I ndodhur mes këtyre problemeve, në një moment Paulin Radovani ka vendosur që të shkojë në prokurori dhe të denoncojë disa prej emrave, të cilëve ai vetë apo dy djemtë e tij i kishin marrë para hua.

ata borxhet që kishte. Disa të tjerëve nuk arriti që t'ia shlyente fajdet dhe kështu nisën që edhe t'i bënin presione. Në një moment, ish-prefekti edhe është goditur tekta ka qenë duke shkuar në shtëpinë e tij, ndërsa mësohet se ka dy urdhra mbrojtjeje nga gjykata pikërisht për shkak të këtyre problemeve. Besnik Barbullushi, një emër i njohur në Shkodër pak kohë më parë u vetëvar dhe kjo ngjarje dyshohet se

ka ndodhur pikërisht për shkak të një borxhi të madh që i ka dhënë familjes Radovani dhe duke ditur pamundësinë për t'i marrë mbrapsht ato para është vetëvarur. Dy djemtë e ish-prefektit kohët e fundit janë arratisur jashtë Shqipërisë për t'i shpëtuar përndjekjes nga fajdexhinjtë, ndërsa vetë ish-prefekti mësohet se ndodhet ende në Shkodër. I ndodhur mes këtyre problemeve, në një moment Paulin Radovani ka

vendosur që të shkojë në prokurori dhe të denoncojë disa prej emrave të cilëve ai vetë apo dy djemtë e tij i kishin marrë para hua. Pas denoncimit të tij, prokuroria dhe policia nisën hetimet ndërsa shumë prej bisedave janë regjistruar nga vetë ish-prefekti Radovani, i cili ka pasur një përgjues që ia kanë dhënë prokurorët kur ka diskutuar këto çështje me fajdexhinjtë. Pas rreth dy muajsh erdhën edhe arrestimet

DHUNA NDAJ ISH-PREFEKTIT

Ish-prefekti është goditur tekta ka qenë duke shkuar në shtëpinë e tij, ndërsa mësohet se ka dy urdhra mbrojtjeje nga gjykata pikërisht për shkak të këtyre problemeve. Besnik Barbullushi, një emër i njohur në Shkodër pak kohë më parë u vetëvar dhe kjo ngjarje dyshohet se ka ndodhur pikërisht për shkak të një borxhi të madh që i ka dhënë familjes Radovani dhe duke ditur pamundësinë për t'i marrë mbrapsht ato para është vetëvarur.



Operacioni i koduar "Maranaj" në Shkodër

në kuadër të operacionit "Maranaj", duke vënë në pranga shtetasit: Byrhan Alija, 61 vjeç, Edi Memçaj 33 vjeç, Adri Bala 22 vjeç, Artan Dragan i ish kancelar ne gjykatën e Shkodrës 39 vjeç, Marjan Bregu 31 vjeç, Vinko Nikprelaj 37 vjeç, Eduart Fusha 38 vjeç, Elidon Qerimaj 41 vjeç, Pashko Vuk-sanelaj 54 vjeç, Lul Sylja 48 vjeç, Naim Ahmetaj 52 vjeç dhe Ilir Sokoli 38 vjeç, ish drejtor i patentave në Shkodër. Policia ka të shpallur në kërkim edhe tre shtetas të tjerë E.M., J.A. dhe E.L. ndërsa janë pezulluar nga detyra dhe kanë masën e sigurisë "detyrim paraqitje" shtetasit Valbona Hajdari notere në Shkodër dhe Ergys Lohja, efektiv policie. Sipas burimeve në çdo lëvizje që bën ish-prefekti Radovani shoqërohet me polici për shkak të këtyre problemeve dhe kërcënimeve që mund të ketë. Policia po heton për rolin e gjithsecilit nga 12 të arrestuarit, një pjesë e të cilëve janë të njohur të ish-prefektit apo djemve të tij më përpara.

DEKLARATA



"Fajdexhinjtë",
Ministri Lleshaj:
Goditje
madhore krimin

TIRANË - Goditje madhore ndaj krimin të organizuar dhe financave e ka quajtur ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, finalizimin e operacionit të madh në Shkodër, që çoi në pranga 12 persona. "Ky sukses motivon me tej policinë dhe qytetarët për të vijuar së bashku përpjekjen për Shqipërinë europiane", - shkruan ministri në "Twitter".

POSTIMI NË "TWITTER"

"Maranaj", për një Shkodër e Shqipëri të lirë nga krimi. Policia e Shtetit dha sot një tjetër goditje madhore kundër krimin të organizuar dhe financave të tij. Ky sukses motivon me tej policinë dhe qytetarët për të vijuar së bashku përpjekjen për Shqipërinë europiane.

Drogë çokollatë, kokainë e armë, prangosen 5 persona në Lushnjë dhe babë e bir në Fier

Policia e Durrësit dhe ajo e Fierit kanë finalizuar dy operacione antidrogë, ndërsa në pranga kanë përfunduar 7 persona. Gjatë operacionit të parë, blutë e qytetit bregdetar prangosën 5 persona, ndërsa sekuestruan 21 kg kanabis, në formë çokollate. Ka qenë një hetim një mujor që ka çuar në realizimin e operacionit dhe personat janë kapur në stacionin e trenit në Lushnjë. Ky është operacioni i dytë antidrogë pas atij të Fierit, ku u arrestuan babë e bir. Sipas të dhënave zyrtare, seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në DVP Durrës



në bashkëpunim me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Forcën e Posaçme Operacionale të Drejtorisë Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas një hetimi disamujor finalizoi me sukses op-

eracionin policor të koduar "Vazhdimësia". Si rezultat u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: A.C., 53 vjeç; G.K., 38 vjeç; I.K. 50 vjeç; R.K. 25 vjeç; L.Y., 47 vjeç, banues në Lushnjë. Këta shtetas gjatë operacionit u kapën në flagrancë

pranë stacionit të trenit Lushnjë me një sasi prej 21 kg lëndë e dyshuar narkotike në formë çokollate, (kanabis sativa), e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale së bashku me dy automjete dhe një sasi parash. Ndërkaq, operacionin e koduar "Befasia", duke vënë në pranga shtetasit A.L., 55 vjeç, banues në Patos dhe A.L., 26 vjeç, banues në Patos (babë e bir). Gjatë operacionit policia gjeti dhe sekuestrroi në cilësinë e provës materiale: 900 gram

lëndë narkotike në formë çokollate, 9 doza me lëndë narkotike e dyshuar kokainë, 6 doza me lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa, 1 peshore elektronike e cila shërbente për ndarjen e drogës në doza të vogla, 1 Pistoletë tip Bereta me 1 krehër dhe 3 fishekë, 4 pasaporta me identitete të ndryshme, 5 aparate celularë. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Nxitja për përdorimin e drogës" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak".



Huat me interesa nga 3-20%. Nëse s'kthehej borxhi për një javë, u mermin pronat qytetarëve

Shkatërrohet grupi kriminal që jepte para me fajde, arrestohen 12 persona e 4 në kërkim

Mes të arrestuarve, ish-drejtori i LSI-së tek patentat dhe ish-kancelari i gjykatës së Shkodrës

SHKODËR

Një rrjet kriminal që jepte para me fajde është zbuluar dhe shkatërruar nga policia dhe prokuroria e Shkodrës. Pas afro dy muaj hetimesh ka rezultuar se në skemën e fajdeve janë përfshirë 22 persona, ku 12 prej tyre kanë përfunduar në pranga, mes të cilëve dhe ish-kancelari i gjykatës së Shkodrës, Artan Dragani dhe një ish-drejtes i LSI-së tek patentat në qytetin verior. Bëhet fjalë për Ilir Sokolin, i cili u kap në doganën e Morinës në Kukës, në tentativë për tu arratisur. Mësohet se në skemën e mashtrimit janë përfshirë dhe policë e noterë. Ndërkohë, janë shpallur në kërkim dhe katër persona të tjerë. Në kuadër të operacionit të koduar "Maranaj", noterja Valbona Hajdari dhe dy punonjës policie u pezulluan nga detyra, ndërsa janë sekuestruar makina, prona, armë dhe rreth 500 mijë euro. Në këtë operacion që nisi në orët e para të mëngjesit të djeshëm u përfshinë 160 forca policie dhe më shumë se 30 mjete. Si pas hetimeve të prokurorisë, është vërtetuar përfshirja e këtij grupi personash në veprimtarinë e organizuar të dhënies së huas, jashtë sistemit bankar, të shumave të konsiderueshme të të ardhurave monetare. Huat janë dhënë me interesa shumë të larta, që variojnë nga 3-20% në javë nga ana e personave të implikuar. Nëse paratë nuk ktheheshin për një javë, anëtarët e këtij grupi u merrnin qytetarëve pronat, shpesh të cilat gjithçka që kishin.



Ish-kancelari i gjykatës së Shkodrës, Artan Dragani



Paratë e sekuestruara gjatë operacionit të djeshëm

REAGIMI



Operacioni me 11 të arrestuar, Rama: Shkodra, sot më e sigurt

TIRANË - Kryeministri Edi Rama ka reaguar për operacionin e koduar "Maranaj" në Shkodër, ku përfunduan në pranga 12 persona si dhe 4 të tjerë u shpallën në kërkim të akuzuar për fajde dhe gjobënie. Përmes një postimi në "Twitter", Rama përgëzon forcat e policisë për operacionin dhe thotë se Shkodra sot është më e qetë dhe më e sigurt se asnjëherë tjetër. "Përhëndetje dhe përgëzime të gjithë forcave policore që u angazhuan në superoperacionin e Shkodrës, duke gmontuar dhe çuar prapa hekurave një grup kriminal keqbërësish. Sot Shkodra është më e qetë e më e sigurt se asnjëherë dhe Policia e Shtetit çdo ditë më efikase #RESPEKT", shkruan Rama.

NJOFTIMI I PROKURORISË

Më datën 25.01.2019 Prokuroria e rrethit gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal me numër 109, mbi bazën e akteve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër. Nga veprimet e kryera me mjete të hetimit proaktiv, të autorizuara nga Prokuroria dhe legjitimuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër rezultoi e provuar përfshirja e një numri të madh shtetasish në veprimtarinë e organizuar të dhënies hua jashtë sistemit bankar së shumave të konsiderueshme të të ardhurave monetare. Dhënia hua e këtyre shumave është për interesa shumë të larta që variojnë nga 3%-20% në javë nga

OPERACIONI
Në operacionin e koduar "Maranaj" morën pjesë 160 forca policore dhe 30 automjete të policisë, përfshirë edhe automjete për transportim mjetesh transporti. Ndërkaq, policia e Shtetit nën drejtimin e Prokurorisë po vijon veprimet për të zbardhur rolin dhe aktivitetin e tyre apo personave të tjerë të lidhur me ta.

PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT "MARANAJ"	U EKZEKUTUAN MASAT E SIGURISË
1. Byrhan Alija 61 vjeç nga Shkodra	Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi Publik" dhe "Detyrim paraqitje" për tre shtetas:
2. Edi Memcaj, 33 vjeç nga Shkodra	1. V.H., nga Shkodra
3. Adri Bala 22 vjeç nga Shkodra	2. A.S., nga Shkodra
4. Artan Dragani 39 vjeç nga Shkodra	3. E.L., nga Shkodra
5. Marjan Bregu 31 vjeç nga Shkodra	U SEKUESTRUAN NË CILËSINË E PROVËS MATERIALE
6. Vinko Nikpreljaj 37 vjeç lindur në Podgoricë dhe banues në Shkodër	- 238 600 euro cash
7. Eduard Fusha, 38 vjeç nga Shkodra	- 272 400 dollarë cash
8. Elidon Qerimaj, 41 vjeç, nga Shkodra	- 414 000 lekë
9. Pashko Vuksanlekaj, 54 vjeç nga Shkodra	- 510 paund britanikë
10. Lul Sylja, 48 vjeç nga Shkodra	- 20 automjete transporti
11. Naim Ahmetaj 52 vjeç lindur në Pukë dhe banues në Tiranë	- 1 revolver
12. Ilir Sokoli 38 vjeç, banues në Shkodër	- 1 krehër pistolette me fishekë
	- 1 armë gjahu pa leje
	- 5 kompjutera laptop
	- 50 celularë
	- Dokumente, kontrata, akte dhe deklarata noteriale, për pasuri e transaksione financiare të dyshuara.
NË KËRKIM	
Janë shpallur në kërkim 4 persona	

ana e personave të implikuar. Gjatë hetimit të kryer rezultoi përvetësimi nga ana e të dyshuarve të disa pasurive të luajtshme, automjete të regjistruara në emër të tyre dhe pasurive të paluajtshme (toka, apartamente, dyqane), prona për të cilat kishte kaluar pronësia në emër të të dyshuarve.

Si rrjedhojë e veprimeve të përgjimeve telefonike, ambientale, vëzhgimit, të legjitimuar nga Gjykata, administrimit të akteve shkrësore, këqyrjeve etj., rezultoi përfshirja në veprimtarinë kriminale e 22 personave emrat e të cilëve u regjistruan si autorë të veprave penale të "Ushtrim pa licencë i veprimtarisë bankare", me pasojë të rënda, në bashkëpunim, "Pastrim i produkteve të veprës penale", "Shpërdorim detyre" dhe "Moskallëzim të kimit", të parashikuar nga nenet 170/c/2, 25, 287, 248 dhe 300/1 të Kodit Penal. Me miratim të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër janë caktuar dhe ekzekutuar masat e sigurimit

personal "arrest në burg" për 11 shtetas, që janë B.A.; I.M., M.B.; L.S.; N.A.; A.B.; A.D (me detyrën ish kancelar në Gjykatën e Shkodrës); V.N.; E.F.; E.Q.; P.V. Janë shpallur në kërkim shtetasit me inicialet E.M.; J.A.; I.S dhe E.L.. Janë ekzekutuar masat e sigurimit personal "pezullim i ushtrimit të detyrës" për noteren pranë Dhomës së Noterisë Shkodër, V.H. dhe SPZ pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër E.L.. Është ushtruar kontroll në një numër të madh banesash, kontroll i kryer me vendim të gjykatës. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar një numër i madh automjesh, vlera të konsiderueshme monetare (rreth 500.000 euro), aparate celulare etj. Veprimet e kontrollit, sekuestrimit dhe veprimeve të para hetimore vijnë në

AKUZAT
Burime zyrtare nga prokuroria bënë me dije se si rrjedhojë e veprimeve të përgjimeve telefonike, ambientale, vëzhgimit, të legjitimuar nga Gjykata, administrimit të akteve shkrësore, këqyrjeve etj., rezultoi përfshirja në veprimtarinë kriminale e 22 personave emrat e të cilëve u regjistruan si autorë të veprave penale të "Ushtrim pa licencë i veprimtarisë bankare", me pasojë të rënda, në bashkëpunim, "Pastrim i produkteve të veprës penale", "Shpërdorim detyre" dhe "Moskallëzim të kimit".

Janë ekzekutuar masat e sigurimit personal "pezullim i ushtrimit të detyrës" për noteren pranë Dhomës së Noterisë Shkodër, V.H. dhe SPZ pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër E.L.. Është ushtruar kontroll në një numër të madh banesash, kontroll i kryer me vendim të gjykatës. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar një numër i madh automjesh, vlera të konsiderueshme monetare (rreth 500.000 euro), aparate celulare etj. Veprimet e kontrollit, sekuestrimit dhe veprimeve të para hetimore vijnë në


Masakra në ish-Bllok, biznesmeni akuzohet për vrasje në bashkëpunim

Gjykata e la të lirë, Ervin Mata i bën kërkesë prokurorisë: Dua të flas për ngjarjen

Klodiana lala

TIRANË

Biznesmeni Ervin Mata, një prej personave të përfshirë në konfliktin e përgjakshëm të 4 tetorit të vitit të kaluar në zonën e ish-Bllokut, i është drejtuar prokurorisë së Tiranës, me një memo, përmes të cilës kërkon të japë shpjegime për ngjarjen, ku një person mbeti i vranë dhe dy të tjerë u plagosën. Memoja iu është dorëzuar dy prokurorëve të çështjes, nga avokati mbrojtës, Alban Bengasi, pasi biznesmeni Mata, ndaj të cilit rëndon akuza e vrasjes kryer në bashkëpunim, nuk ka dhënë deri më tani shpjegime për ngjarjen. Burime nga prokuroria thanë se e kanë administruar kërkesën e Matës dhe javën e ardhshme ai do të thirret për të dhënë versionin e tij për krimin, ku viktimë



mbeti Fabian Gaxha, dhe u plagosën biznesmeni Ervis Martinaj e miku i tij Eljo Hato. Ervin Mata, i fejuari i këngëtares Elvana Gjata, u lirua nga gjykata vetëm nën masën e detyrimit të paraqitjes. Vendimi i shkallës së parë është apeluar nga

prokuroria, e cila kërkon kthimin në burg të biznesmenit. Sipas institucionit të akuzës, gjykata nuk i ka vlerësuar drejt provat dhe faktet duke caktuar një masë sigurie, që nuk i përgjigjet rëndësisë së ngjarjes. I dyshuari Mata u

vetëdorëzua në polici, pesë muaj pas ngjarjes së rëndë. Sikurse edhe të dyshuarit e tjerë, edhe ai u lirua nga gjykata. Për momentin në burg, mbahet vetëm Ervis Martinaj, ndërsa vijon të jetë në arrati komando Meviol Bilo, i cili dyshohet se qëlloi

në drejtim të Fabian Gaxhës, në momentin kur ky i fundit nxori armën dhe qëlloi në mes të lokal Monopol. Motiv i krimit, dyshohet të jetë një ngacim verbal që iu bë jashtë ambienteve të lokalit, të fejuarës së Matës, këngëtares Elvana Gjata.

LIRIMI I BIZNESMIT

Burime nga prokuroria thanë se e kanë administruar kërkesën e Matës dhe javën e ardhshme ai do të thirret për të dhënë versionin e tij për krimin, ku viktimë mbeti Fabian Gaxha, dhe u plagosën biznesmeni Ervis Martinaj e miku i tij Eljo Hato. Ervin Mata, i fejuari i këngëtares Elvana Gjata, u lirua nga gjykata vetëm nën masën e detyrimit të paraqitjes.



Fitonin 4 mijë euro në ditë, fundosën 5 trafikantët shqiptarë

ITALI - Pesë shqiptarë janë arrestuar sot në Rimini të Italisë për akuzën mbajtjes dhe të shitjes së lëndëve narkotike. Sipas mediave fqinje, të arrestuarit janë të moshave nga 18-28 vjeç. Ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin shisnin kokainë në doza të vogla në stacionet e autobusëve duke siguruar një xhiro prej 4 mijë eurosh brenda një dite. Pas arrestimit, autoritetet vijuan kontrollet në rezidencën e tyre, ndërsa gjetën mjete të tjera që i përdorte grupi si telefona, thika dhe një sasi të konsiderueshme parash, vlera e të cilave nuk është bërë publike nga autoritetet italiane. Nga të dhënat e siguruar është vërtetuar se shqiptarët, paratë e drogës që i fitonin në Itali i sillnin më pas për t'i investuar në Shqipëri.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

TENDER OPPORTUNITY FOR TAXI SERVICE BUSINESS at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Experience of provision and installation of taxi services (not necessarily service for airport). Please note at least 1 year of experience is necessary.
- Taxi license of the company related to the subject of the concession (any company which fails to meet the above criteria will not be taken into consideration).
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas, only on 19 March 2019 up to 15:00 Eastern Time.

Only to the companies that will submit a formal request for participation will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or **to all** the following email address:

Tirana International Airport Nënë Tereza SH.P.K
Administration Building
Commercial & Property Department
Rinas, Albania

Emails:
Commercial Department Alisa Gjinari agjinari@tirana-airport.com
Legal Department Ilir Alimema ialimema@tirana-airport.com
Procurement Department Albi Palushi apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

STAFF TRANSPORT SERVICES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Staff Transport Services for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com specifying request for information for "Staff Transport Services".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail. This tender will be organized in two phases:

1. In the first phase, companies will need to present: references though similar services performed for other companies, list of vehicles, respective licenses.
2. In the second phase, short listed companies will need to submit their financial offer.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Staff Transport for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:
Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **12:00 hrs. on 21 March 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com



Dje gjatë aktivitetit në universitetin 'Luarasi'

Zv.rektorja Anni Dasho Sharko: Qasje e re për të rinjtë e karrierën profesionale

Konkurs në fushën e teknologjisë, "ICT Awards" me studentët e "Luarasit"

Kushtrim Shala: I kënaqur për partneritetin me universitetin

Voltiza Duro

Deri në 30 mars të këtij viti, individët me projektet dhe idetë më të mira në fushën e teknologjisë dhe inovacionit mund të bëhen pjesë e konkursit rajonal "ICT Awards". Bashkëthemeluesi i kësaj platforme, Kushtrim Shala ka prezantuar para studentëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në universitetin "Luarasi" procedurën e kandidimit në edicionin e shtatë të konkursit. "Me ftesë të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe Inovacionit në universitetin "Luarasi", 'Albania ICT Awards' ka nderin dhe kënaqësinë të takojmë studentët për t'iu ilustruar një ndër mundësitë më të shkëlqyera për sa i përket promovimit të karrierës së tyre. Bëhet fjalë për 'ICT Awards', e cila është një platformë a konkurs që shpërblen të rinjtë e talentuar në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky është edicioni i shtatë dhe përgjatë këtyre viteve kemi arritur të identifikojmë dhe të promovojmë shumë raste, duke i ekspozuar jo vetëm me publikun e gjerë shqiptar, por edhe promovuar me ekspertizat më të mira ndërkombëtare, me investitorët shqiptarë dhe të huaj dhe duke korrur kështu histori suksesi të jashtëzakonshme individësh shqiptarë", - tha Shala.



Anni Dasho dhe Kushtrim Shala gjatë prezantimit

diplome, e cila duhet të jetë praktike, me një produkt konkret. Më vjen shumë mirë që bashkëpunimi ynë po thellohet duke nënshkruar kështu edhe një marrëveshje bashkëpunimi me këtë universitet. Jemi

shumë të kënaqur që kemi arritur një partneritet të tillë me një universitet mjaft inovativ si "Luarasi", - u shpreh Shala më tej. Zv.rektorja e universitetit, Anni Dasho Sharko thotë se kjo mundësi është një qasje

e re për studentët, që do t'i ndihmojë në karrierën e tyre dhe në të ardhmen profesionale. Ajo ka qenë pjesë e jurisë së "ICT Awards" dhe tregon disa prej ideve më inovative nga të apasionuarit pas teknologjisë. "ICT Awards" vjen në vitin e dytë në 'Luaras'. Është një qasje e re dhe themi që do kemi projekte të mira të lançuara nga studentët tanë të 'Luarasit'. Ide inovative vijnë nga viti në vit dhe gjithmonë e në rritje, duke na bërë të mendojmë që duhet të përgatisim një brez që të jetë sa më inovativ në fushën e ICT-së", - tha Sharko. Objektivi kryesor i "ICT Awards" është shfaqja e arritjeve të shqiptarëve në fushën e TIK-ut, si dhe të identifikohen, të shpërblehen e promovohen individët më të dalluar të kësaj industrie.

KUSHTRIM SHALA

PROMOVIMI

"Ky është edicioni i shtatë dhe përgjatë këtyre viteve kemi arritur të identifikojmë dhe të promovojmë shumë raste, duke i promovuar me ekspertizat më të mira ndërkombëtare, me investitorët shqiptarë dhe të huaj dhe duke korrur kështu histori suksesi të jashtëzakonshme individësh shqiptarë", - tha Shala.



ANNI DASHO

IDE INOVATIVE

"ICT Awards" vjen në vitin e dytë në 'Luaras'. Është një qasje e re dhe themi që do kemi projekte të mira të lançuara nga studentët tanë të 'Luarasit'. Ide inovative vijnë nga viti në vit dhe gjithmonë e në rritje, duke na bërë të mendojmë që duhet të përgatisim një brez që të jetë sa më inovativ në fushën e ICT-së", - tha Sharko.



APLIKIMI

Aplikimi në "ICT Awards" mund të kryhet individualisht, por edhe në grup. Projekti është i ndarë në 7 kategori, ku përfshihet edhe "Diploma e vitit" që pritet të ketë kandidatura edhe nga studentët e "Luarasit". Kushtrim Shala shprehet i kënaqur për partneritetin dhe bashkëpunimin me këtë universitet. "Gara është e hapur për të gjitha projektet e bëra nga individë të caktuar. Por, kjo nuk përjashton rastet e aplikimeve nga individë pas punës së të cilit qëndron një grup. Është e ndarë në shtatë kategori: mobiliteti i vitit, diploma e vitit e cila edhe lidhet me ftesën time në këtë universitet, ku ftojme të gjithë ata studentë që kanë realizuar një temë

"Kujdes, mos harroni formularët e kërkuar"

Vizat në SHBA, ambasada: Çfarë duhet të keni parasysh ditën e intervistës

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka dhënë një këshillë për ata që do të shkojnë në ambasadë për t'iu intervistuar për vizën. Ambasada këshillon që çantat e mëdha qytetarët e interesuar t'i lënë në shtëpi dhe të mos kenë asgjë në xhepa. "Gëzuar Ditën e Verës! Unë dhe Kenny mezi po e presim motin e ngrohtë dhe si çdo të enjte, unë jam gati për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja rreth vizave.



Ja dhe këshilla ime për këtë javë: Kur të vini në ambasadë për intervistën tuaj për vizë, lërin çantat e mëdha në shtëpi. Ejani vetëm me pasaportën tuaj, formularin e konfirmimit DS-160 dhe formularët e tjerë të kërkuar. Gjithashtu, sigurohuni që të hiqni gjithçka nga xhepat përpara se të hyni në ndërtesë", - thotë ambasada në njoftimin e saj. Përgatitja për intervistë

"Ju duhet të përgatiteni për intervistën tuaj me kujdes. Pamundësia për t'u përgatitur plotësisht për intervistën tuaj në Ambasadën ose konsullatën e SHBA mund të rezultojë në vonesë ose mohim të aplikimit për vizë. Pasi të keni njoftuar për intervistën tuaj të planifikuar, do t'ju duhet të ndërmerrni hapat e rëndësishëm përpara datës së intervistës", - bën me dije Departamen-

ti Amerikan i Shtetit. Fillimisht duhet të shqyrtohet me kujdes informacioni i caktimit në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV, duke shënuar datën, kohën dhe vendndodhjen e intervistës për vizën e emigrantëve. Më tej duhet të merren në shqyrtim Udhëzimet e Intervistës së Ambasadës së SHBA-ve ose konsullatës.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën e 611 pronarëve të njohur që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosjet të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

suhet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara të nënshtruarve të procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Shkodër	Fadil Jera	659	340
Tiranë	AGIM BEJA	1778	1027
Tiranë	AGIM BEJA	691	360
Tiranë	AGIM BEJA	2887	0
Vlorë	Qemal Sulo		5000
Vlorë	Vangjel Mati	5000	1600
Korçë	Eftimi Mile		1656
Korçë	Vasil Qelesi		2067
Korçë	Pëllumb Bujari		4000
Elbasan	Refat Hima		1150
Tiranë	MILTO SOTIR DUSHI	2305	1220
Vlorë	Orest Papagjika		0
Vlorë	Lumturi Rexha		5000
Vlorë	Hekuran Dalani		3600
Vlorë	Durim Boraku	300	3300
Shkodër	Zef Luke Tanushi		1450
Tiranë	YMER BAKALLI	10939	71
Vlorë	Skënder Kobure		300
Elbasan	Emine Hima, Mehmet Serica	560	4300
Fier	Llamber Prifti	1820	7180
Fier	Enver Zoto		8000
Fier	Shefit Zoto		5600
Fier	Irfan Kembora		6970
Fier	Osman Sharko		2400
Fier	Ristan Biti		800
Fier	Gori Gjini	10000	1060
Fier	Ibrahim Xhindole		10000
Fier	Xhemal Xhindole		10410
Fier	Muharem Nezha	1600	8400
Fier	Rrapi Sula		5000
Fier	Bajram Sula		3375
Fier	Vasil Petushi	5244	0
Korçë		244	38.5
Korçë	Naum Furxhi		32.8
Shkodër	Jup Kastrati		161
Tiranë	NASI SIMAKU		346
Kukës	Man Çela		171700
Shkodër	Sait Shaban Shega	1495	301
Tiranë	YMER BEQIRI	85	717
Elbasan	DILAVER LLALLA		4200

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Kukës	Sadri Rustem Danaj		3200
Tiranë	ISMAIL PEMA (PEZA)		500
Tiranë	Jonuz Haka		0
Durrës	Ylvis Izeti	5000	16325
Korçë	Hasan Saliko	379	2326.5
Korçë	Kristaq Palo	208	2314
Korçë	Muharem Nuri Rusi	1798	1679
Korçë	Demir Meçolli		880
Korçë	Vellazeria Temo		2683
Korçë	Jani Mosko	101.7	71.9
Korçë	Athina Panja		140
Korçë	Rexhep Belliu	7626	2648
Tiranë	Ahmet Shkreta	8158	1956.3
Vlorë	Xhemile Hysomemeaj	2700	6650
Vlorë	Panajot Llazari	2267	393
Vlorë	Paskal Doko	400	1800
Vlorë	Sotir Beko		3000
Vlorë	Sofie Kondo		400
Korçë	Andoneta Qelesi	33	100
Korçë	Ligor Rëmacka	750	750
Durrës	Dilaver Mustafa Domi		1250
Korçë	Qamil Hanelli	60	1210
Shkodër	Aleksander Petani	90	380
Shkodër	Aleksander Petani		2033
Vlorë	Sulo, Aliko		40
Vlorë	Isa Zeqir Meta		48
Durrës	Ylli Leka	1457.2	4524
Tiranë	OSMAN MEHMET MUÇA	6272	300
Cjirokastër	Leonora Proko, Llazar Qirici	423	3281
Vlorë	Myrvete Curri		1000
Fier		1467.5	5000
Korçë	Viktor Barbuta	1200	6539
Vlorë	Kosta Melo	3788	600
Cjirokastër	Maliq Basha	10385	900
Korçë	Feti Molla		5880
Tiranë	YLVI KAZAZI	210	303
Tiranë	DILAVER BEXHET HOXHOLLI		264.5
Korçë	Dhimitra Dishnica		5730
Cjirokastër	Maliq Bido Basha	10670	615
Korçë	Ali Spaho	673	957

Korçë	Sanije Spaho	330	1050
Korçë		1544	456
Korçë		251	293
Korçë	Verore Shahu		620
Korçë	Kosta Argjiri	365	827
Shkodër	Fran Zef Marku		0
Tiranë	SHTUFI	5300	900
Tiranë	XHELADIN VLORA	1534	2012
Tiranë	Evgjenia Papakostandini	405	550.43
Tiranë	NEXHAT PILKU	285	465
Tiranë	ELENI NUSHI	112	854.9
Durrës	Anita Rroço	8228	3501.75
Korçë	Bukurie Meka (Azra), Faik Meka	1481.5	1659.75
Korçë	Petro Ketri	110	300
Vlorë	Irashëgimtarët		324
Vlorë	Sadete Juka	1865	165
Fier	Andrea Papaj		0
Fier	Ramazan Kaloshi	5518	4982
Fier	haxhi Bejko	480	5420
Korçë	Shefqet Agolli		2183
Korçë	Stavrulla Grazhdani		0
Korçë	Fatmire Lame	4492	640
Korçë	SOT IRAQ KRIST ANI	2712	0
Lezhë	Beg Paj Haxhiu	10000	8340
Shkodër	Enver Kraja	9506	560
Tiranë	VANGJEL E STAVRI ÇOKA	29700	120300
Elbasan	Selaudin Vyshka	3124.55	3329.55
Gjirokastrë	Gani Banushi		3600
Tiranë		10000	1050
Tiranë	Mithat Llagami		930.17
Fier	Jorgji Semanjaku	316	444
Fier	Sherif Kepucka	2590	3844
Fier	Servet Malasi	3440	11056
Tiranë	Komuniteti Mysliman	272	32
Tiranë	SULEJMAN DERVISHI	172.5	192.5
Berat		3200	17320
Durrës			14762
Fier	Novruz Dalla	1050	1750
Fier	Hasan Manko		3300
Shkodër	Bajazit Kuci	49	52
Durrës	Stefanaq Boshku		2282
Durrës			257.5
Durrës		369	229
Durrës	Teodor Gjergji	5000	7850
Durrës	Kostandin Heba	20000	64590
Durrës	Ylli Bekteshi		1875
Elbasan	Zarif Tabaku		2123
Elbasan	FATMIR MIRAKA		1908
Gjirokastrë	Hyse Shehu	2150	1850
Korçë	Koco Como		269
Korçë	GAZMENT MENKULASI		2380
Korçë	Medi Hoxha, Zeqir Hoxh		420
Korçë	Enverije Hoxha		420
Korçë	Rene Dangelli, Zydije Dangelli		1000
Korçë	Edmon Begolli		2000
Korçë	Kadri Dangellia		2250
Korçë	Vasil Gjino	150	392
Korçë	Nesime Lilo	1905	1203
Korçë	Ylli Iljazi	882	858
Korçë	Nazmi Shamo	638	1546
Durrës	Islam Gjonaj	1985	500
Durrës	Beqir Previzi		400
Durrës	Riza Deliallisi	5000	34000
Korçë	Nakir Beqiri	620	3215
Korçë	Gjylo Shahu	666	1601
Korçë	Medi Hasan Canko		3886
Korçë	Lefter Binjaku	444	156
Shkodër	Hasan Pirani		343
Vlorë	Vasil Gjoka	630	870
Korçë	Skender Kello	4060.25	9773.8
Fier	Fatime Kallfes		10260
Fier	BUSHI POPE		6000
Fier	Sabri Dedej		10680
Fier	Mehmet Çela		10000
Fier	GEZIM LIBOHOVA	5815	11728
Fier	Ismail Sharka		3400
Fier	Shefit Sheqj		7200
Fier	LUAN HASANBELLIU		5600
Fier	Nuredin Zgiona	4910	5350
Shkodër	Viktor Tonin Jubani	2170	1330
Korçë	Teki Meka	664	31007.95
Korçë	Fredi Babani		254.3
Korçë	Nezaqet Mero		25.5
Vlorë	Llanda Bamiha		2500
Durrës	Spiro Qirko		3826.8
Gjirokastrë	Ermioni Tako	433	403.6
Gjirokastrë	Novruz Duralliu		98
Korçë	Enverie Ajçe	4830	620
Tiranë	Ali Bali	4112	6479.5
Tiranë	AGIM DOKU	1815	2965
Fier	Safet Elmazi	9077	1400
Fier	Hysen Hodaj		3600
Fier	Shaban Pepa		3100
Fier	Sabri Malkaj		4725
Fier	Esmat Shehaj		10150
Fier	Zagoll Mucaj		10500
Gjirokastrë	Zyra Maliq Bushi	5000	5101
Gjirokastrë	Dalip Meta	2400	7871
Korçë	Kimete Zhupani	504	562
Durrës	Bajram Vrioni		7894
Fier	Themi Ziu		10160
Korçë	Parashqevi Plaku	3224	233
Korçë	Rami Baçka	1256	169
Korçë	Ismail Aliçkolli	2661	6671
Korçë	Myseret Elmazi Ademi		1400
Tiranë			530
Tiranë	HAXHI BEGEJA	95	127
Korçë	Fejzulla Leka, Hamdi Leka	997	2047
Korçë	Neim Cela		10500
Gjirokastrë	Godol Resul Koka		0
Gjirokastrë	Dalan Halit Gjoku		5397
Tiranë	VAJE QOKU	5470	4632.4
Elbasan	Adem Hida		3700
Gjirokastrë	Safet Mero		9800
Gjirokastrë	Astrit Pasho	150	880
Gjirokastrë	Spiro London		1309
Korçë	Gani Sulka	308	3560.2
Korçë	Mazlleni Bylyku	465	598
Korçë	Ilia Vangjeli	958	200
Korçë	Liljana Vangjeli	1056	306
Korçë	Ramadan Ismolli		298
Korçë	Xhaferr Shamo	930	1156
Korçë	Thomaidha Papargjir		1550
Korçë	Qeti Cico	132	1578.2
Gjirokastrë	Hajri Mullai		1776
Korçë	Qanie Memelli	180	420
Korçë	Sami Feto	1325	947
Korçë	Ali Canko, Safet Canko	515	3626
Gjirokastrë	Kajame Ymeraj	1291	5027
Fier	Aqif Mata	1270	9300
Shkodër	Myzafer Lezha	8250	1840
Tiranë	SUDE T ABAKU	86	104
Tiranë	HYSEN SHARRA		355.94
Gjirokastrë	Avni Maliq Licaj		10086
Tiranë	KUJTIM LLAZANI		1002

(vijon)

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga 'Agjencia'

ALUIZNI publikon listën me 1110 personat që kanë gati lejet e legalizimit në Vorë dhe Kamës. Përfutuesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por përfutuesit duhet të shkoi në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefshji i sipërfaqes së bazës së ndërimit dhe për ndërimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

ALUIZNI: 1110 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Lista me pronarët në qarkun e Kamzës dhe Vorës

ive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefshji i sipërfaqes së bazës së ndërimit dhe për ndërimit pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërimit, i shiten poseduesit

nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMIT

Table with 4 columns listing names and numbers of individuals who have completed the legalisation process. The list is organized in four columns, starting with names like EMER ATESI MBIEMER and ending with names like FAYMIR ALI DEDA.

Table with 4 columns of names and numbers, listing individuals and their associated identifiers. The table is organized into four vertical columns.

Detaje nga festa e personazheve publikë

Ja si e uruan VIP- at shqiptarë Ditën e Verës

Bes Kallaku: Shyqyr që ju ka gjetur shëndosh!

Egla Xhemali

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë pagane. Karakteristikë e kësaj dite janë çelja e luleve dhe gjelbërimi, të cilat simbolizojnë mirësinë dhe gjallërimin e jetës, pa harruar këtu edhe ëmbëlsirën tradicionale të kësaj feste, ballokumen. Çdo vit nëpër qytete organizohen një numër i madh aktivitetesh për të gjithë njerëzit, të cilët mezi e kanë pritur këtë festë. Të shumtë kanë qenë edhe VIP-at që kanë uruar dhe festuar këtë ditë.

Miriam Cani ka uruar të gjithë fansat e saj "Gëzuar ditën e verës". Këngëtarja ka postuar dy foton në "Instagram" ku duket mjaft e lumtur me ardhjen e stinës së pranverës. E veshur thjeshtë me një buzëqeshje të stampanuar në fytyrë Miriam duket shumë e ëmbël. Pas saj duket disa gjethë të vogla që janë me nuanca ngjyrash.

As ai nuk mund të mos u mungonte urimeve për festën



e 14 Marsit." Shyqyr që ju ka gjetur shëndosh! Më mirë vitin tjetër inshallah!" ka shkruar Bes Kallaku bashkëngjitur me foton e lules që simbolizon pranverën.

"Mos i fol shoferit" ka pasur disa kërkesa për ditën e verës. "Dua ballokume shumë të mirë, dua një vazo me borziloq, dua dhe një masazh relaks. Kaq pak kërkoj nga jeta" - shkruan Rudina Dem-

bacaj në 'Instastory' duke mos harruar të bëj dhe pak humor.

Edhe Oriola Marashi u ka uruar ndjekësve të saj ardhjen e pranverës. Përmes një story në "Instagram", ku duket dora me verore e një bebushi modelja shkruan: Gëzhuar ditën e velës. Modelja nuk është ndalur me kaq. Ditën e djeshme ajo ka postuar edhe disa foto të tjera të saj, ku si gjithmonë duket në super formë.

Një tjetër këngëtare që ka uruar 14 Marsin ishte dhe Soni Malaj. Bukuroshja përmes një fotoje në rrjetet sociale shkruan: Gëzuar ditën e verës! E veshur me një fustan me lule e mes një ambienti plot ngjyra, Soni duket më në formë se kurrë. Duket se pranvera është stina e saj.

Për të "Dita e verës" do një kavanoz me "Nutella". Einxhel Shkira e ka festuar në mënyrën më të mirë të mundshme ardhjen e stinës së luleve. Moderatorja është ëmbëlsuar pafund me "Nutella". Në një postim në "Instagram" bukuroshja e ekranit ka ndarë një foto që mesa duket u ka hapur të




gjithë nepsin.

Këngëtarja e njohur Poni ka uruar ditën e verës në mënyrën më speciale. Ajo ka publikuar një video të djalit të saj duke kënduar

Siç mund të dëgjohet, zëri i tij është mjaft i intonuar, duke na bërë të kuptojmë se

Frenk ka të trashëguar pasionin për muzikë nga e ëma. Nuk dimë të themi nëse kur të rritet i vogli i këngëtares do ndjekë rrugën e mamasë së tij, por talenti nuk mungon. Krahas kësaj video këngëtarja ka shkruar: "Mëngjes vere, gëzuar Ditën e Verës".



Enca në Irak? Këngëtarja paralajmëron diçka të re

Enca prej kohësh tashmë ka synuar tregun ndërkombëtar dhe fama e saj ka qenë mjaft e madhe në vendet me popullsi arabe. Këngëtarja gjithmonë e ka pranuar këtë fakt duke i përshëndetur shpeshherë fansat e saj nga ky vend, por së fundmi ajo ka filluar të jetë prezente edhe në mediat e këtyre vendeve.

Enca ka zbuluar se ka qenë e ftuar në një nga emisionet e njohura në Irak të quajtur 'Rudaw'. Këngëtarja ka postuar në "Instagram" një video, ku shihet teksa po intervistohet nga gazetarët e huaj. "Ishte një kënaqësi", ka shkruar Enca pranë videos ku në fund përshëndet gjithë fansat e saj në gjuhën arabe.



Madje ajo ka treguar se në mars do të bëjë një koncert atje, dhe i fton fansa e saj që të shkojnë ta ndjekin.



Pa make up dhe filtra! Shikoni si duket Xhemi Shehu

Xhemi Shehu njihet si një ndër femrat më të bukura të ekranit shqiptar. Ajo gjithnjë shfaqet e kuruar dhe mosha duket se nuk ka ndikuar fare tek ajo, pasi në shumicën e kohës nuk e ka problem aspak të tregojë sesi duket pa ato filtrat e 'Instagramit' dhe pa pikë makijazhi.

Në një selfie të publikuar dje në Instagram, moderatorja ka pozuar shumë natyrale. Jo më larg se të dielën, Xhemi guxoi me një veshje mjaft seksi në "Portokalli", dhe na tregoi rezultatet e palestrës, ku e shohim të shkojë thujse çdo ditë. Xhemi i ruan linjat dhe është fanse e madhe e stërvitjes dhe palestrës dhe kjo ishte mënyra e duhur për të na treguar!




Tuna përfundon në spital, zbuloni kush po kujdeset për të

Eftuar në koncertin e këngëtares Tuna Sejdiut ishte edhe Soni Malaj, e cila zbuloi një ditë para eventit, se Tuna ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore. Teksa i shprehte pamundësinë për të shkuar, Soni i uronte këngëtares shërim të shpejt!

Mirëpo, gjatë ditës së djeshme, këngëtarja ka publikuar një video, ku tregon se është në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe pranë saj ndodhet make up astisti Kaçi Lleshi. 'Infermieri me krejt aftësitë e veta Kaçi Lleshi para setit', shkruan Tuna për mikun e saj, i cili po kujdeset për të, bashkë me Kaçin ndodhet edhe Patrisi.

Nuk dihet se çfarë po kalon këngëtarja, por fansat janë shqetësuar për të. Ata presin sa më shumë hite nga ajo.



Tayna kopjon yllin botëror? Ja çfarë na bëri të dyshojmë

Tayna sapo ka publikuar klipin e saj për hitin më të fundit 'Kce'. Në këtë klip, duket se Tayna është fokusuar plotësisht tek fuqizimi i vajzave, teksa në klip ka mbledhur një grup me vajza shumë seksi, ndër

to dhe Kejvina, ish-velina e njohur e emisionit 'Xing' me Ermalin. Nuk është çudi që Tayna ka ardhur me këtë koncept, të cilin tanimë e kemi parë gjerësisht si tek këngëtare të tjera shqiptare si Dhurata Dora, por dhe tek ato të huaja si Ariana Grande, pasi që me lëvizjen 'Me too', është përhapur gjerësisht trendi si në filma dhe në muzikë, i portretizimit të vajzave dhe grave që mbështesin dhe fuqizojnë njëra-tjetrën. Nuk e dimë nëse Tayna është inspiruar nga klipi i Arianës, ashtu siç ndodhi me klipin e këngës 'Pow pow', i cili ngjante shumë me klipin artistit afrikan Lava Lava, apo thjesht ka qenë një rastësi.



Maqedoni e Veriut, DASH vlerësim pozitiv për mediat dhe gjykatat

DASH: Kosova ngec nga korrupsioni, dëbimi i të huajve dhe sulmeve ndaj gazetarëve

Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi raportin mbi të drejtat e njeriut në botë, përfshirë këtu edhe atë të Maqedonisë së Veriut, ku janë dhënë vlerësime pozitive dhe negative në disa fusha. Sipas raportit, korrupsioni mbetet një nga çështjet problematike në vend, ndërsa ka përparime edhe në sferën e gjyqësorit dhe mediave. "Qeveria e Maqedonisë së Veriut në vitin 2018 ka ndërmarrë aktivitete për të humtuar, akuzuar dhe të dënuar persona zyrtarë policorë, të cilët kanë bërë keqpërdorime, ndërsa au-



toritetet në vend kanë pasur kontroll efektiv ndaj shërbimeve të sigurimit, por megjithatë ekziston nivel i lartë i korrupsionit", - thuhet në raport. Një vlerësim negativ është dhënë edhe për gjendjen e rëndë dhe johumane në burgjet e vendit, ku s'është nënvizohet, nuk është aritur vendosja e standardeve ndërkombëtare dhe plotësimi i kushteve për të burgosurit. Raporti citon edhe Avokatin e Popullit dhe raportimet për

parregullsi dhe veprime të paligjshme ndaj të burgosurve. "Në të shumtën e rasteve, gjykatat u përmbahen ligjeve dhe procedurave për paraburgim. Këtë vit numri i urdhrave për paraburgim ka rënë dukshëm në krahasim me vitet e kaluara. Në shumicën e rasteve, në kërkesë edhe të Prokurorisë Speciale Publike, gjykatat ka caktuar masa parandaluese në vend

të paraburgimit për të dyshuarit", - nënvizon raportin. Nota pozitive janë dhënë për gjykatat dhe qasjen ndaj tyre, ku janë evidentuar përparime dhe gjykime korrekte, por edhe pengesa që duhen evituar siç janë pavarësia e kufizuar e gjyqësorisë, politizimi i organeve mbikëqyrës gjyqësor dhe financat e pamjaftueshme për pengesë e mëtejshme për punën dhe efikasitetin e tyre, shkruan INA. Nga ana tjetër, Kosova po ngec si pasojë e korrupsionit dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe pakicave, ka thënë ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Philip Kosnett, duke komentuar raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën. "Një hap përpara i ndër-

marrë ishte miratimi i Kodit të rishikuar Penal. Kosova vazhdon të ngecë si pasojë e korrupsionit, sulmeve ndaj gazetarëve, dëbimit të shtetasve të huaj pa proces të rregullt gjyqësor dhe dhunës ndaj pakicave", ka shkruar Kosnett në "Twitter". Në raportin e DASH-it për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2018, në pjesën për Kosovën përmenden korrupsioni në qeveri, dhuna dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, tha se do të ndërmarri hapa konkrete pas këtij raporti.

Ramush Haradinaj: Gjermania është partner i rëndësishëm i Kosovës

Delegati i BE: Brukseli i angazhuar të arrihet marrëveshja Kosovë-Serbi

Eksperti amerikan: Thaçi është mashtruar nga Vuçiq e Putin

Ditën e djeshme, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka takuar deputetët e komunitetit turk, Müferra ?inik dhe Enis Kervan, me të cilët ka bashkëbiseduar rreth përfshirjes së këtij komuniteti në delegacionin shtetëror për dialogun me Serbinë. Haradinaj ka thënë se pakicat etnike në Kosovë duhet të përfshihen në procesin e dialogut me Serbinë. "Komunitetet jo shumicë, përfshirë edhe turqit, janë pjesë e pandashme e realitetit të Republikës së Kosovës, duke u dhënë mbështetje të gjitha proceseve të shtetndërtimit. Fuqizimi i turqve të Kosovës në kontekst të dialogut me Serbinë ndikon në forcimin e pozicionit të vendit tonë si shoqëri e vlerave, siç janë shumetniciteti dhe diversiteti kulturor", ka shkruar kryeministri në "Facebook". Ndërkaq, Bashkimi Evropian do të vazhdojë të ndërmjetësojë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka deklaruar të mërkurën raportuesi i Parlamentit Evropian, David McAllister. Ai ka thënë për RTV "Vojvodina" se BE-ja beson se gjëja më e rëndësishme është që Prishtina dhe Beogradi t'i kthehen tryezës së negociatave në Bruksel. "Natyrisht se do të kishte kuptim që fuqitë e tjera të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Rusia t'i bashkoheshin debatit politik, në mënyrë që ai të ecte përpara. Ne gjithmonë debatojmë me fuqitë jashtë BE-së. Ajo çfarë duam në fund është të shohim një zgjidhje të qëndrueshme, e cila është e pranueshme për të dyja palët", ka deklaruar McAllister.



Filiali qendror i Bashkimit Evropian

DAVID MCALLISTER

"Natyrisht që do të kishte kuptim që fuqitë e tjera të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Rusia t'i bashkoheshin debatit politik, në mënyrë që ai të ecte përpara. Ne gjithmonë debatojmë me fuqitë jashtë BE-së. Ajo çfarë duam në fund është të shohim një zgjidhje të qëndrueshme, e cila është e pranueshme për të dyja palët", ka deklaruar McAllister.

BE-së. Ajo çfarë duam në fund është të shohim një zgjidhje të qëndrueshme, e cila është e pranueshme për të dyja palët", ka deklaruar McAllister. Nga ana tjetër, ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, ka ripërsëritur dje se Këshilli i Sigurimit i OKB-së do të ishte një shembull logjik, që duhet ndjekur nëse Beogradi dhe Prishtina arrijnë një marrëveshje. "Është një vazhdim logjik i

ngjarjes. Gjithçka që pajtohemi duhet të kalojë përmes një trupi të huaj për të fituar legjitimitet ndërkombëtar, për të verifikuar atë që kemi rënë dakord", tha kryediplomati serb për televizionin "Happy", duke komentuar deklaratën e kryediplomates evropiane, Federica Mogherini, se marrëveshja e ardhshme mes të shqiptarëve dhe serbëve duhet të pranohet nga Këshilli i Sigurimit. Në

fjalimin e saj në Këshillin e Sigurimit në OKB, Mogherini kërkoi që marrëveshja finale të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, por edhe të ketë mbështetjen nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. "Më lejoni të falënderoj secilin prej jush për qasjen konstruktive të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ndaj dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Për rifillimin e plotë të bisedimeve, tarifave e vendosura nga qeveria e Kosovës ndaj produkteve serbe duhet hequr. Ditën kur kjo do të ndodhë, do të thërras menjëherë një takim të ri për dialogun, në mënyrë që të arrihet një marrëveshje ligjërshite e detyrueshme, e cila do të adresojë të gjitha çështjet e jashtëzakonshme dhe do të sjellin normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit", - tha Mogherini.

SHKURT

Ministri grek: Zgjerimi i vijës bregdetare, prioritet i Tsipras

Në një intervistë për radiostacionin "Real Fm" dhe gazetarin Nikos Haxhinikolau, ministri grek i Jashtëm, Jorgos Katrugalos, ka folur edhe për ecurinë e marrëdhënieve bilaterale me Shqipërinë. Gjatë bisedës, gazetari është referuar në dialogun e mëparshëm mes dy dikastereve si dhe në deklaratat nxitëse në vijim të palës shqiptare, duke pyetur nëse këto episode kanë bllokuar procedurat dhe si po ecin negociatat konkretisht për Zonën Ekskluzive Ekonomike në detin Jon. Ministri grek është përgjigjur se vonesat vijnë për shkak të trazirave të Shqipëri, por edhe për mungesën e përgjigjeve për minoritetin grek. "Është e drejtë vërejtja për sa i përket vonesës në negociatë, ka arsye, ne padyshim që marrim parasysh trazirat politike në vendin fqinj. Ndërkohë që duhet të marrim edhe përgjigje për çështjet e parashtruara dhe madhore të minoritetit grek. Konkretisht janë dy ligje që referohen në të drejtat përkatëse, ligji për mbrojtjen e pasurisë së palëvizshme në bregun e Himarës, si dhe ligji i përcaktimit të identitetit, që ofron mundësinë e deklarimit si minoritar në procesin e regjistrimit. Janë dhënë disa përgjigje nga pala shqiptare, në një farë mënyre mund të them se kanë rifilluar diskutimet, por është akoma tepër herët të parashikojmë rezultatet. Megjithatë, theksoj sërish se vullneti ynë është ecuria dhe përmirësimi i çështjeve bilaterale, e përmes këtij përmirësimi të hapet dhe rruga europiane për Shqipërinë". Në lidhje me deklaratat e mëparshme të qeverisë greke, përfshi edhe të ish-ministrit Nikos Koxhias për vijën bregdetare dhe zonën ekskluzive ekonomike, ministri Jorgos Katrugalos ka deklaruar se, "zgjerimi i vijës bregdetare dhe përcaktimi i zonës ekskluzive ekonomike është ndër prioritetet e kryeministrit Cipras.



Ministri spanjoll: Rastet e Kosovës me Katalonjën sjajnë njësoj

Ministri i Jashtëm i Spanjës, Josep Borell, deklaroi në Beograd se rasti i Kosovës dhe ai i Katalonjës nuk janë të krahasueshëm, sepse siç tha ai, të dyja situatat nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. "Këto dy situata nuk kanë të bëjnë fare me njëra-tjetrën. Ajo që ndodhi në Kosovë nuk ka të bëjë fare me gjendjen e Katalonjës", tha ministri i Jashtëm spanjoll, i pyetur nga Radio Evropa e Lirë nëse është çështja e Katalonjës është arsye pse Spanja nuk e njeh Kosovën. Pas bisedimeve me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe ministrin e Jashtëm serb, Ivica Dačić, shefi i diplomacisë spanjolle tha se vendi i tij kundërshton pavarësinë e Kosovës, por edhe kërkon zgjidhje kompromisi në kuadër të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. "I përsëritëm presidentit dhe ministrin të Jashtëm qëndrimin e Spanjës për mospranimin e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë mendojmë se vetëm përmes dialogut mund të arrihet deri te një zgjidhje e kompromisit në këtë çështje", tha Borell në një konferencë për mediat. Nga kabineti i presidentit Vuçiq është njoftuar se gjatë takimit, ai ka thënë se Serbia sillet me përgjegjësi sepse ka përmbyshur të gjitha detyrimet nga marrëveshjet e Brukselit. "Prishtina ndërkohë me platformën e dialogut ka treguar se është kundër dialogut", ka thënë Vuçiq. Në njoftim thuhet se Borell, i cili po qëndron për vizitë në Serbi, ka thënë se njohja e Kosovës është e papranueshme pasi është "kundër të drejtës ndërkombëtare".

Scaparrotti: Rusia financon parti në Ballkan kundër NATO-s

Gjenerali amerikan: Moska mundohet të minojë përparimin drejt integritimeve euroatlantike

Komandanti i trupave amerikanë për Europën, gjenerali Curtis Scaparrotti akuzon Moskën se po financon parti politike në Ballkan për të penguar integritimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Europian dhe NATO. "Ata bëjnë përpjekje për të minuar çdo përparim drejt integritimeve euroatlantike, BE, NATO etj. Këtë e bëjnë kryesisht përmes dizinformimit, e bëjnë duke financuar dhe mbështetur parti radikale. Ata jo domosdoshmërisht përcaktojnë se cilin krah mbajnë. Rëndësi ka që të minojnë qeverinë aktuale në çdo hap të hedhur përpara. Shohim që ky ak-



Komandanti i trupave amerikanë për Europën, gjenerali Curtis Scaparrotti

tivit është shtuar gjatë 6 apo 8 muajve të fundit në Ballkan". Gjatë një raportimi përpara anëtarëve të Komisionit të Shërbimeve

Ushtarake të Dhomës së Ulët të Kongresit Amerikan, gjenerali Scaparrotti paralajmëroi se rusët mund të organizojnë akte

CURTIS SCAPARROTTI
"Ata bëjnë përpjekje për të minuar çdo përparim drejt integritimeve euroatlantike, BE, NATO, etj. Këtë e bëjnë kryesisht përmes dizinformimit, e bëjnë duke financuar dhe mbështetur parti radikale. Ata jo domosdoshmërisht përcaktojnë se cilin krah mbajnë. Rëndësi ka që të minojnë qeverinë aktuale në çdo hap të hedhur përpara. Shohim që ky aktivitet është shtuar gjatë 6 apo 8 muajve të fundit në Ballkan", ka thënë gjenerali.

dhune në Maqedoninë e Veriut para anëtarësimit të plotë në NATO. "Hyrja e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në NATO besoj se janë të papranueshme për Rusinë. Besoj se ata vazhdimisht do të përpigjen të ndërhyjnë në Maqedoninë e Veriut siç bëjnë me Malin e Zi". Moska e ka shprehur hapur qëndrimin kundër anëtarësimit në NATO të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, pavarësisht se ka mohuar përfshirjen në tentativën për grusht shteti në Mal të Zi që u zbulua Tetorin e vitit 2016. Disa ditë më parë, edhe kreu i Këshillit Europian, Donald Tusk ngriti shqetësimin se Rusia po përpigjet të ndërhyjë në zgjedhjet e disa vendeve europiane, përfshirë këtu edhe rastin Brexit.

Dalja e Britanisë nga BE, deputetët britanikë votuan shtyrjen e saj

Brexit, Bashkimi Europian e çon afatin deri në 2021

Trump mirëpret një marrëveshje tregtare me britanikët

E dhe pse i duheshin vetëm 15 ditë nga skadimi i afatit, Bashkimi Europian ka vendosur të lërë të hapur mundësinë e shtyrjes së afatit të shkëputjes së Britanisë së Madhe. Këtë e bëri të qartë Presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk, pasi parlamentit britanik refuzoi të martën lëshimet që Brukseli i bëri kryeministres Theresa May në marrëveshjen e shkëputjes me Londrën. Përmes një postimi në "Tëitter"////, Tusk thotë se do t'u kërkonte 27 vendeve anëtare të unionit të ishin të gatshëm për një shtyrje të gjatë të afatit të Brexitit, nëse Britania e Madhe e sheh të nevojshme rishikimin e strategjisë së shkëputjes nga Bashkimi Europian. Kjo çështje është futur edhe në axhendën e takimeve që Tusk do të zhvillojë duke nisur nga 15 marsi me kryeministrin holandez, Mark Rute në Hagë, Kancelaren Angela Merkel në Berlin, Presidentin francez Emmanuel Macron dhe që përmbillen të martën me kryeministrin irlandez, Leo Varadkar. Javën e ardhshme, Theresa May do të dërgojë sërish në votim marrëveshjet e refuzuar dy herë nga parlamenti britanik, pasi mbrëmjen e të mërkurës deputetët hodhën poshtë mundësinë e daljes pa marrëveshje nga unioni. Ndërsa ditën e mërkurë u thirr një tjetër votim, ku parlamenti shprehu se është dakord me shtyrjen e afatit të Brexit-it. Londrës mund t'i lihet kohë deri në vitin 2021 që të negociojë një marrëveshje nga e para, por nuk përjashtohet mundësia e një referendumi të dytë për Brexitin. Ndërkaq, parlamenti britanik zhvilloi dje të tretin votim brenda 3 ditëve për Brexit. Shtyrja është kërkuar nga kryeministrja Theresa May, e cila nuk po arrin të bindë deputetët për marrëveshjen që ajo ka arritur me Brukselin. Mbrëmjen e të mërkurës, parlamenti votoi kundër dal-



jes pa marrëveshje nga Bashkimi Europian. Ndërsa natën e të martës, deputetët refuzuan edhe lëshimet që i bëri Unioni kryeministres Theresa May. Nga ana tjetër, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se mirëpret një marrëveshje të gjerë tregtare ndërmjet SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe. Komentet e presidentit amerikan bëhen në kohën kur dalja e Britanisë nga Bashkimi Europian ka hyrë në një periudhë të paqartë. "Administrata ime mirëpret bisedimet për një marrëveshje të gjerë tregtare me Britaninë. Po-

tenciali është i pakufishëm", ka shkruar Trump në "Tëitter"////. Ligjvënësit britanikë votuan dje për të kërkuar leje nga Bashkimi Evropian për shtyrjen e Brexit-it, apo daljes së Britanisë nga BE ja, pas datës 29 mars, e cila është e parë tani për tani. Votimi pason kundërshtimin e ligjvënësve britanikë ndaj marrëveshjes së rishikuar ndërmjet qeverisë britanike dhe Bashkimit Evropian. Ekspertët kanë paralajmëruar se Brexit-i pa marrëveshje do të shkaktojë recesion në Britani dhe do të ngadalësonte rritjen ekonomike në BE.

Aksidenti në Shkup, përfundojnë hetimet

Tragjedia në Llaskarcë, prokuroria: Shkak ishin frenat e shpejtësia, në pranga 7 persona

Ditën e djeshme Prokuroria Themelore Publike në Shkup ka publikuar rezultatet e hetimit që kanë shkaktuar aksidentin tragjik në Llaskarcë, ku u mori jetën të paktën 15 persona. Sipas prokurorit Sasho Rajçev, hetimi ka zbuluar se aksidenti ka ndodhur për shkak shpejtësisë së madhe dhe parregullsive së frenave të autobusit dhe se është manipuluar tahografi. Janë ndaluar shtatë persona në mesin e të cilëve edhe pronari i "Durmo Tursit" dhe shoferi i autobusit. Një muaj pas aksidentit tragjik të autobusit të kompanisë "Durmo Turs", në afërsi të fshatit Llaskarcë, Prokuroria Publike dje shpalli që parregullsia e frenave të autobusit dhe shpejtësia janë shkaqet e aksidentit ku humbën jetën 15 persona. Sipas shefit të Prokurorisë Publike Shkup, Sasho Rajçev, janë ndaluar shtatë persona, të cilët dyshohen për vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pronës në trafik. "Hetimi ka treguar se frenat kanë qenë pjesërisht në rregull, por edhe pse kjo është konstatuar në kontrollin teknik në Korrik të vitit 2018, i është dhënë leja e punës. E njëjta gjë është bërë edhe gjatë kontrollit teknik në dhjetor të vitit 2018. Në mënyrë plotësuese është vërtetuar se është manipuluar me tahografin, ku nuk është treguar shpejtësia reale e autobusit. Shoferi atë ditë ka ecur me 99 kilometra në orë. Për automjetet mbi 3 tonë, shpejtësia e lejuar është 80 kilometra në orë. Autobusi peshon 15 tonë. Parregullsia e frenave dhe shpejtësia janë shkaqet për aksidentin". Prokuroria do të kërkojë masën e paraburgimit për gjashtë persona, respektivisht për shoferin, pronarin dhe drejtuesin e kompanisë dhe për të punësuarit në firmën për kontroll teknik të autobusit.



SHKURT

Iran, shpërthimi i gazsjellësit shkakton viktima e të plagosur

Shpërthimi që ndodhi në një gazsjellës në jugperëndim të Iranit kanë vdekur të paktën katër persona, raportojnë mediat lokale. Shpërthimi ndodhi për shkak të një rrjedhje gazi nga tubacioni që ndodhet midis kryeqytetit provincial, Ahvaz, dhe qytetit Mahshahr-it. Në mesin e të vdekurve janë edhe një fëmijë dhe një grua ndërkaq pesë persona të tjerë u plagosën. Nga ekipet e zjarrfikësve bëhet e ditur se zjarri përfshiu edhe disa mjete transportuese të udhëtarëve. Megjithatë, autoritetet thonë se numri i viktimave ende nuk është përfundimtar. Irani ka një infrastrukturë të jetës, të cilën është përpjekur ta mbajë në funksion përgjatë gjithë periudhës disaveçare të përbaljes me sanksione të vendeve perëndimore. Në gusht të vitit 2018, një shpërthim gazi në një kompleks sportiv në Teheran vrau të paktën tre punëtorë.

Rusi, burg për aktivistin që krijoi varrin e Putinit

Një gjykatë në Rusi ka dënuar me 28 ditë burgim, një burrë që ka krijuar një varr për presidentin rus, Vladimir Putin. Në gurin e varrit të krijuar ishte vendosur fotografia e Putinit dhe vjetët e jetës, 1952-2019. Aktivisti Karim Yamadayev është dënuar të martën në qytetin, Naberezhnye Chelny për shkelje të vazhdueshme të ligjit, duke krijuar ngjarje të tilla publike. Ai ka thënë ta ketë bërë një gjë të tillë kundër një projektligji për "sovrانيتetin e internetit" në Rusi, duke thënë se po kjo masë kërcënon lirinë e shprehjes. Të mërkurën Rusia ka miratuar dy projektligje që ndëshkojnë mosrespektimin e autoriteteve dhe shpërndarjen e lajmeve të rreme. Në ndalimin e parë përfshihet "mosrespektimi" i shtetit, zyrtarëve dhe shoqërisë ruse dhe përsëritja e këtyre veprave mund të dënohet me 15 ditë burgim. Dokumenti i dytë ndalon shpërndarjen e "informacioneve të rreme që lidhen me interesin publik". Gazetarët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe disa ministrave të qeverisë ruse kanë shprehur kundërshtimet e tyre për këto masa, duke thënë se "Perdja e re e Hekurt" është duke u vendosur kësaj here mbi internetin. Nën udhëheqësinë e Putinit, shteti rus ka fituar kontrollin e një pjese të madhe të kanaleve televizive, prandaj zërat opozitarë dëgohen më së shumti përmes rrjeteve so-

DOKUMENTE

Avioni bombardues amerikan, që ra në 10 gusht 1944 dhe unaza e xhaketa e vjedhur pilotit Walter Green

Nga Ylli Polovina

Regimi realkomunist, duke qenë shumë kohëgjatë, pothuaj një gjysmëshekullor, arriti të hedhë mbi shumë ngjarje të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri terrin e harrimit. Hesh-tja shpesh është më e diabolike se manipulimi tjetërsues që mund t'i bëhet një ndodhie apo figure historike. Ajo e kryen më lehtësisht diversionin e censurës, shpëlarjes dhe shuarjes nga kujtesa kolektive.

Kështu ka ndodhur edhe me kontributin e dukshëm të aleatëve anglo-amerikanë për rezistencën shqiptare antifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilën vetëm disa libra kujtimesh të misionarëve të tyre ushtarakë kanë mundur sadopak ta rehabilitojnë pjesërisht, në fragmente të vogla.

Gjithsesi, mbeti pothuaj në boshllëk informimi jo vetëm lufta dhe ndihma e tyre me aksione konkrete luftarake, me armë e veshje, me flori po ashtu, por sidomos ajo nëpërmjet bombardimeve nga ajri.

Evropa të vetat i kujton një për një, madje të filmuara, në jo, na duket si çështje e një bote tjetër, jo që e kanë përjetuar gjyshërit apo baballarët tanë.


Fragmentet e këtij kontributi të censuruar po mblidhen pak nga pak, por tepër ngadalë, shpesh me shumë ç'interimes, ndërsa me kohë duhet të përbënin temën e një apo disa librave të posaçëm, të një e më shumë dokumentarëve, lapidarëve po ashtu.

Që kjo ngathtësi ka qenë e mbetet një dukuri e shtritur sa gjerë gjatë, ndërsa realiteti dëshmon një rol shumë aktiv të flotës ajrore anglo-amerikane në qiejt shqiptarë në betejë me nazi-gjermanët, e provon edhe një korrespondencë midis Hary Fultzit dhe Enver Hoxhës.

Është 26 tetor 1945, kur në emër të Sherbimit të Jashtëm të SHBA, zëvendësprerfaqësuesi amerikan në Tiranë i shkruan kryekomunistit shqiptar:

"I nderti Gjeneral-Kolonel Hoxha!

Tuj folur me Kapiten Fred Philby, i cili erdhi në Shqipëri më 29 shtator 1945, për të mblledhur informatat e përkohshme të Amerikanëve të vrarë në Aeroplanët e Rrëzuar, mora vesh se koha që i asht dhanë është vetëm për 1 muaj për vizitën e Tij këtë. Mbasi nuk ka pas mundësi me bla planin e origjunaem, aj ndien që duhet ta nd-



jekin urdhërat e përparshme për t'u kthye në bazën e Tij në Itali.

Në kjoft se mund të bahen prgatitjet tjera, Kapiten Philby ka me ba vizitën e dytë për të kompletue investigimin e aeroplanave të rrëzuar si mbas planeve të prgatiturë.

Ju falenderoj për interesimin t'Uaj në kët çështje dhe me respektë të veçantë mbetemi, i dashur Gjeneral-Kolonel Hoxha".

Kjo letër e Fultzit u përpilua dhe u dërgua në adresë të Enver Hoxhës në të njëjtën ditë, 26 tetor 1945, kur një të tillë hartoi dhe nisi edhe Fred C. Philby.

Ky, duke e nënshkruar "Kapiten i Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara", i thoshte numrit një të Shqipërisë së pas Luftës: "I Nderti Gjeneral-Kolonel Hoxha! Lutem pranoni mirënjohjen t'ime personale për fisnikërinë që treguat kundrejt meje gjatë qëndrimit t'im në vendin t'Uaj në këto kohët e fundit. Më vjen keq që konditat atmosferike dhe veçanërisht në Zona t' izoluar me ndalojnë të plotësoj misionin. Me lejen t'Uaj shpresoj të këthehem në Prandërë ku moti do të jetë më i përshtatur".

nisur Enver Hoxhës, katër ditë më herët, në 22 tetor, një tjetër letër.

Duke lënë të nënkuptuar se para kësaj ka qenë edhe një letër e mëparshme, patjetër e para 22 tetorit 1945, Fred Philby shkruan: "Unë përsëri kam nderin t'Ju kërkoj leje që t'i vizitoh ato pjesë të Shqipërisë ku janë rrëzuar aeroplana të Shteteve të Bashkuara dhe ku ndodhen eshtrat e dëshmorëve t'anë, me qëllim që të siguroj informata të sakta në lidhje me lokalitetin dhe identifikimin para se t'i transportojmë për në Shtetet e Bashkuara.

Lutemi na njoftoni sa më parë që të jetë e mundur".

RRËZIMI I AVIONIT TË PARË

Në Berat, prej nga ku vjen edhe vendlindja e autorit të këtij shkrimi, gjatë viteve të Luftës ka pasur dy avionë luftarakë aleatë, të cilët kanë rënë. Që të dy janë rrëzuar në periferi të tij, madje në të njëjtën kah gjeografik: në verilindje.

Rasti i parë i rrëzimit ka qenë, gjatë periudhës komuniste, përherë ngjarje e ditur dhe i cituar në mjedise të mbyllura, në mënyrë absolute pa e nxjerrë publikisht dhe përhapur. Për këtë ndodhi kam mundur që në vitin 1972 të mblledh të dhëna shumë origjinale, të cilat nuk janë ende publikuar. Por ndërkohë për këtë episod historia jonë ka pasur fat: është shkruar fillimisht një libër në anglisht, tashmë përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Më pas është botuar në të njëjtën gjuhë edhe një libër i dytë.

Autorja e parë quhet Agnes Jensen Margerich, libri i saj titullohet "Albanian escape" ("Shpëtimi në Shqipëri"). Autorja e dytë e ke emrin Cate Lineberry dhe libri "The secret rescue" ("Shpëtimi sekret").

Sipas botimit të Agnes Jensen Margerich, në 8 nëntor 1943, pra kur Italia fashiste pati kapitulluar dhe Shqipërinë e kishin pushtuar gjermanët, në fshatin Çestije të Belshit, Elbasan, kreu një gjysmë rrëzimi një avion amerikan transporti "Dakota C-53". Ishte nisur nga aeroporti i Katanas në Sicili për t'u ulur në Bari, por gjatë fluturimit një stuhi e paparashkruar i këputi lidhjen radiofonike me bazën dhe mes resh të dendura e në pëshjellim e sipër të motit, kur kishin kaluar pesë orë udhëtim të ankthshëm, karburanti që në pikën e fundit dhe nga toka (qyteza e Kuçovës) gjermanët qëlluan me artileri, gjeti menjëherë një vend të sheshtë dhe bëri ulje emergjente.

Ata tridhjetë persona që ndodheshin në bord (13 infermiere nën-togere të skuadrës së evakuimit ajror, 13 meshkuj sanitarë dhe 4 të

ekuipazhit), panë t'u afroheshin njerëz të armatosur që nuk flitnin italisht. Qenë, siç rezultoi për fat të tyre, partizanë shqiptarë. Po të mbërrinin të parët gjermanët, të cilët e panë çfarë ndodhi dhe u nisen edhe ata, fati i amerikanëve do të ish më e pakta një kamp përqendrimi.

Të mbetur në duart e partizanëve, gjatë dhjetorit, përmes një udhëtimi shumë të rëndë, ia dolën të dilnin në bregdetin jonian dhe të riktheheshin në Italinë e Jugut.

Rasti i dytë kishte një datë tjetër, dhjetë muaj më vonë: 10 gusht 1944.

Këtë herë avionit që një bombardues. Si edhe i pari ishte i flotës ajrore luftarake amerikane.

RRËZIMI I AVIONIT TË DYTË




Në 1 tetor 1945 Legata Jugosllave në Tiranë i dërgonte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë një notë verbale me numrin 256. Kur shkresa mbërriti në MPJ, ajo ra në dorë të punonjësit me emrin Beni.

Ishte e nesërmja, 2 tetor.

Pikërisht këtë ditë, 2 tetor 1945, me siglat identifikuese "VF LP" (Vdekje fashizmit-Liri Popullit) si edhe "Mbretinija Shqiptare Ministria e Punëve të Jashtme" (Megjithë një vit çlirim, për shkak të mungesës së letrës së bollshme përdoshin sidomos nga MPJ, format shkresore të periudhës së pushtimit), i protokolluar me numrin 478/1, i dërgohej ky mesazh "Komanës së Përgjithshme t'Ushtrisë Kombëtare, Tiranë".

Teksti i saj thoshte: "Me lutje që të na jipni informatat e duhura, këtu poshtë, ju komunikojmë, në përthim, notën Nr. 256, datë 1 Tetor 1945, të Legatës Jugosllave në Tiranë, e cila interesohet për fatin e Togerit t'aviacionit amerikan Walter O. Green që është rrëzuar me aeroplanin e vet, më 10 gusht 1944, afër Beratit".

Më pas: "Simbas kërkesës së Ministrisë së P të Jashtme të Belgradit, Legata e Jugosllavisë Demokratike-Federative ka nderin të vrapojë në ndërmjetësinë dashamirëse të Ministrisë së P të Jashtme të Shqipërisë dhe t'i lutet të ketë mirësinë t'interesoheh pranë Autoriteteve kompetente shqiptare mbi fatin e Walter O. Green, toger i aviacionit amerikan. Aeroplani i tij ka qenë rrëzuar në 10 Gusht 1944, ora 13 e gjysmë afër Beratit. Në qoftë se nuk është rob luftar (djetor) ose i zënë rob lufte prej Gjermanëve, familja e tij beson se Walter Green-i dhe shoku i tij Cloer kanë marrë pjesë në lëvizjen nacional-çlirimtare të Shqipërisë. Togerit Green ishte 20 vjeç. Ay ishte i gjatë



nga shtati, afro dy metra, dhe flokët i kishte shumë kuqurumë".

Dhjetë ditë më vonë, në 12 tetor, nga vetë Gjeneral Kolonel Enver Hoxha, komandant i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, Ministrisë së Jashtme i erdhi përgjigja si më poshtë po ja paraqesim lexuesit: "Simbas informatave që disponojmë, rezulton se në muajin korrik 1944 është rëzuar në katundin Gorenjë të Beratit një aeroplan tip "bombadonjës".

Ekuipazhi i përbërë prej katër pilotash është hudhë me parashuta dhe ka zbritë në katundin Lapardha të Beratit.

Aty janë marrë në dorzim nga ushtarët e Ballit Kombëtar dhe u janë dorëzuar Gjermanëve.

Katundari që i ka kap qubet Jusuf Miraku, i cili posedon edhe një unazë me inicialet B.D. dhe që pretendon se ja ka dhuruar njëri prej pilotëve.

Mbasi ushtari i Ballit është në duart e drejtësis për ndjekje ligjore, u pyet mbi karakteristikat e aviatorëve dhe deklaroi:

Nuk ishim më të mëdhenj se 20-21 vjeç, kishin shtat mezatat dhe flokët që të katër i kishin si të kuqëremë.

I nalt përmenduri nuk di ma gjatë mbi fatin e tyre.

Jemi në kërkim e sipër nëpër elementa të tjerë Ballistë dhe porsa t'informohemi do t'u vëjmë në dijeni".

Si vijim plotësues të kësaj shkresë të 12 tetorit 1945 Enver Hoxha në 8 dhjetor i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme, nën siglat "Komanda e Përgjithshme e U. K. Shqiptare", "Vdekje fashizmit Liri popullit", "Rezervat", këtë tekst: "Simbas hetimeve të ma vonshme rezultojnë që ekuipazhi i aeroplanit amerikan rëzuar në katundin

“

Dhjetë ditë më vonë, në 12 tetor, nga vetë Gjeneral Kolonel Enver Hoxha. "Simbas informatave që disponojmë, rezulton se në muajin korrik 1944 është rëzuar në katundin Gorenjë të Beratit një aeroplan tip "bombadonjës".

Lapardha të Beratit të jetë dorëzue ke gjermanët.

Këto informata i marrim nga Komandanti i Rrethit asi kohe Gani Zhapova si edhe nga Abil Qamili. Të dy deklarojnë se ekuipazhi përbëhej prej katër vetash dhe se gjermanët i kanë nisur për Tiranë të shoquem prej forcave të tyre".

Këtu, fillim dhjetor 1945, duket sikur çfarë kërkonte nota e 1 tetorit 1945 e Legatës Jugosllave në Tiranë që plotësuar, por nuk ishte kështu. Pati mbetur në mes. Prandaj edhe për ta çuar gjer në fund të gjithë këtë proces mirë informimi se çfarë fati kishte pasur togeri i avianionit amerikan Walter O. Green, Legata Jugosllave i nisi Ministrisë së Punëve të Jashtme

të Shqipërisë një notë të dytë verbale.

Ajo, siç edhe qe rregullit, ishte në frëngjisht dhe mbante numrin e protokollimit 194.

Është 7 maj 1946.

Po atë ditë Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Këshillit të Naltë të Shtetit (ka vetëm firmën dhe jo emrin) i dërgoi një shkresë Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, duke e vënë në dijeni për notën e dytë të Legatës Jugosllave në Tiranë, gjithnjë për fatin e aviatorit Walter O. Green.

Teksti vinte në dukje: "Aparati që ka qenë pilotuar nga togeri Green është rëzuar në datën 10 gusht 1944. Greem kishte një shtat të gjatë prej afro dy metrash dhe leshrat i kishte të kuqe. Njeriu që ndodhej me të në të njëjtin aeroplan ishte 27 vjeç dhe me një shtat më t'ulët. Motra e Walter O. Green i ka shkruar mëmës së një mitralieri që u varros prej dy anëtarëve të tjerë të ekuipazhit t'aeroplanit të rëzuar, në mënyrë që të mund të konstatohet, nëse ay, para se të bëhej rob luftime prej ballistëve, ka pasur në dorë hunazën me inicialet e veta.

Ministria e P. të Jashtme është e lutur të bëjë demarshet e nevojshme pranë organeve kompetente shqiptare për të mundur eventualisht të nxirren disa informata të reja mbi fatin e Walter Green në virtut të komunikimit të parë.

Ma njoftoni përfundimin".

Në 14 maj Komanda e Përgjithshme e U.K. Shqiptare, Komisioni Informativ Qendror, i dërgoi MPJ.së një shkresë, në vijim të mëparshmeve.

Përmbajtja e saj: "Për hollësinë dhe informata më të gjana drejtëjuni organeve kompetente të Pushkët në vendin e ngjarjes ku asht rëzru Aeroplani i Pilotuar prej Togerit Amerikan Walter O. Green dhe në vendin ku asht hudhë Ekuipazhi me Parashutë. D.M.TH. drejtëjuni Këshillave Nacional Çlirimtare të katundve Goranjë dhe Lapardha ndërmjet Komitetit N/Prefekturës Berat.

Kryetari i Shtabit Madhor Gjeneral major Spiro Moisiu".

Pas kësaj dhe në vijim të korrespondencës Ministria e Punëve të Jashtme i nisi Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare mesazhin: "Lutemi që, me anën e organeve kompetente, t'i kërkohet të burgosurit Jusuf Miraku hunazën e pilotit amerikan Walter O. Green, me inicialet B.D. dhe mandej të na dër-

gohet, mbasi motra e të lartpërmendurit është interesuar për atë hunazë, me anën e Legatës Jugosllave në Tiranë".

Në fund të shkresës së rishit "Sekretari i Përgjithshëm", me firmë dhe pa emër.

BALLISTI QË I VODHI PILOTIT AMERIKAN JO VETEM UNAZËN, POR EDHE XHAKETËN

Ndërkaq dy ditë më parë, në 12 maj 1946, "Komanda e Përgjithshme e UKSH, Adjuntatura e Shtat Madhorisë", i dërgoi misionit amerikan në Tiranë: "Bashkëngjitur ju dërgojmë për dijeni një kopje t'akt-gjykimit mbi të pandehurin Jusuf Miraka, i cili siç do të shifet dhe në akt-gjykimin, në kohën t'okupacionit Gjerman u ka dorëzuar nazistave katër aviatorë Amerikanë, të cilët ranë me parashutë n'afërsitë e Beratit dhe për këtë gjykata në fjalë e ka dënuar të përmendunin me 30 vjet burg.

Të pandehurit Jusuf Miraka ju gjet dhe një unazë e marrun nga Pilotët, e cila bashkë me këtë shkresë ju dërgohet.

Mundësisht na njoftoni marjen në dorëzim.

Shef i Kabinetit Ushtarak Major Qazim Kapisyzi

Më 28 maj 1946 J.E. Jakobs, Përfaqësues Amerikan në Shqipëri, i ktheu këtë përgjigje:

I ndershmi Major Kapisyzi,

Me falenderime njoftoj marjen e letërës t'uaq të datës 26 mars 1946, me kopjen bashkëngjitur të vendimit të Këshillit Gjyqësuar Ushtarak të Qarkut Tiranës, mbi dënimin e Jusuf Miraka me 30 vjet burgim, pse ka bashkë-punue me dy të tjerë në Korrik 1944 në dorëzimin e katër aviatorve Amerikanë, të cilët kanë ra me parashutë, mbasi aeroplani ishte shkatërrue nga Gjermanët afër Beratit dhe pse i ka vjedhur një aviatorit Amerikan një unazë dhe një xhaketë.

Gjith'ashtu njoftojmë marjen e unazës për të cilën i dhashë një deft-eshë prurësit më 26 maj 1946.

Kopjen e letërës bashkë me vendimin e Gjyqit Ushtarak, si edhe unaza ju dërgua Departamentit të Ministrisë s'Luftës.

Kortezia e juaj për t'ja prunë dijeni në këtë Misioni asht shumë e mirënjohëse".

Kur u formula letra e mësipërme marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë nuk qenë në periudhë qetësie, por trazimi të plotë. Në 28 shkurt 1946 Jakobs i pati shkruar qendrës së vet se ishte e domosdoshme që ai të rikthehej në atdhe dhe përfaqësia diplomatike amerikane në Tiranë të reduktohej e gati mbyllej. Atje propozonte të rrinte për pak kohë vetëm Harri Fulci.

Nëpër glob po ashtu tensionet ishin shtuar. Po skicohej silueta e Luftës së Ftohtë, çfarët donte të thoshte se për Washingtonin, në luftë kundër komunizmit, i nevojiteshin të gjitha llojet e anti-komunistëve, përfshi edhe ata që patën bashkëpunuar me fashistët dhe nazistët.

Megjithatë kur bëhet fjalë për rastin e Jusuf Mirakës, Jakobs nuk lëkundet: jo vetëm e quan përgjegjës për kapjen, dorëzimin tek gjermanët dhe për pasojë zhdukjen fizike të katër pilotëve amerikanë, por edhe si hajdut dhe mashtrues ordiner.

Robit të luftës, të pambrojturit Walter Green, i pati zhvatur jo vetëm unazën, por edhe rrobën e trupit, xhaketën, e cila ishte jetike për kushtet që do të kalonte në burgin apo kampe përqendrimi. Gjer ditën e kobshme kur nazistët do t'ia merrnin realisht jetën.

Ndërkaq jo me emrin Jusuf, por Isuf Miraka, në Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist V (Tiranë: ISKK, 2016), 354, gjendet edhe kjo e dhënë: "Lindi më 1910, në Lapardha të Beratit. Më 22 shkurt 1946, Gjykata Ushtarakë e Tiranës e deklaroi "kriminel luftime" dhe "armik të popullit", se "ka qenë komandant i çetave të organizatës tradhtarë e mercenare të Ballit Kombëtar me gradën toger dhe se me këtë cilësi ka dorëzuar në duart e gjermanëve 4 aviatorë amerikanë", dhe në bazë të neneve 14, 15, 18 dhe 19 të ligjit nr. 41, i dënoi me 30 vjet burg, humbjen e të drejtave civile e politike dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Dje në "Deutsche Welle"

Edhe serbët bëjnë gati valixhet

Nga Dragoslav Dedović

(vijon nga faqja 1)

... gjuhëve të huaja. Para 10 vitesh, kur ai e hapi këtë shkollë ishte anglishtja gjuha më e kërkuar, tani gjermanishtja.

TË RINJTË, TË GATSHËM PËR T'U LARGUAR

Tre nxënëse të gjermanishtes të shkollës së tij kanë mbaruar ndërkohë kursin B1 të gjuhës për infermiere. Infermiere të reja me diplomë, që për pak ditë do të shkojnë të punojnë në Gjermani. Jovana dhe Angelina i kanë nënshkruar ndërkohë kontratat e punës me klinikat Asklepios në Hamburg. Miljana do ta fillojë në Tübingen jetën e saj të re, në klinikën universitare. 24-vjeçarja Jovana ka një argument të patundshëm për largimin e saj nga vendi. "Këtu nuk kishte punë për mua. Do të emigroj për shkak të mosgjatjes së vendit të punës".

Leskovci është një qytet i varfër, një qytet, për të cilin thuhet, se përgatit mishin më të mirë në skarë në Ballkan. Por kohët e lavdishme, si qytet i tekstilit dhe industrisë farmaceutike kanë kohë që kanë marrë fund. Askush nuk e quan më këtë qytet "Manchesterit serb", dikur një komunë me 100.000 banorë, sot aty jetojnë shumë më pak se 70.000 veta.

Jovana ka qenë ndërkohë tri herë në Gjermani. Testimi në Berlin dhe Hamburg ishte një përvojë pozitive, punëdhënësit mbetën të kënaqur. "Aty kuptova, se puna në Gjermani dhe Serbi nuk ndryshon shumë. Vetëm tek ndarja



© Dragoslav Dedi

mes kujdestares shëndetësore dhe infermieres edhe tek numri i pacientëve që është i kufizuar. Nuk është kështu në Serbi. Një infermiere është edhe kujdestare. Ajo mund të kujdeset madje për një pavion të gjithë në një spital".

"MADJE EDHE MBIORËT PAGUHEN..."
Për Angelinën 19-vjeçare edhe punë të tilla të lodhshme ishin të pakapshme. "Fqinja ime punonte si sanitare në spital. Ajo ndoqi një kurs të shpejtë dhe u rikualifikua, tani punon si infermiere", thotë ajo e ngre supet. Ndërsa 26-vjeçarja Miljana konfirmon me seriozitet. "Në vendin tim për fat të

keq nuk vlerësohet kualifikimi profesional. Njerëzit i marrin punët në bazë të kriterëve të tjera. Prandaj e shoh të ardhmen time në Gjermani".

Jovana thekson se në Gjermani vlerësohen kualifikimet dhe puna është e paguar mirë. "Madje edhe mbioret paguhen, aboneja urbane të paguhet. Ke një menses, ndihmë deri sa të gjesh apartament, kësaj i shtohen kurset shtesë dymujore të gjuhës. Që të tria vajzat serbe flasin pozitivisht për korrektesën e firmës ndërmjetësuese dhe për përvojat e para me punëdhënësit.

KOMISION EKSPERTËSH

KUNDËR EKSDIT MASIV

Në Serbi rroga mesatare është nën 400 euro. Papunësia në vend sipas shifrave zyrtare është 12%. Disa ekspertë thonë se, nëse nuk do të kishte emigracion, papunësia do të rritej në 20%. Mes të rinjve papunësia kap shifrën 30%. Kështu, largimi masiv i trurit në drejtim të perëndimit është për qeverinë serbe bekim dhe mallkim. Ajo mund të lëvdohet se ka ulur papunësinë, por realiteti në terren është i hidhur për shkak të emigracionit. Ministria e Punës ka bërë të ditur së fundmi themelimin e një komisioni ekspertësh për të gjetur rrugë për uljen e emigracionit ma-

siv.

Për Jovanën, Angelinën dhe Miljanën kjo nuk ka më rëndësi. Të tria e shohin edhe privatisht të ardhmen në Gjermani dhe nuk mendojnë, se do të kthehen më. Vajzat duan të krijojnë më vonë edhe familje në Gjermani. E trishtueshme për prindërit, thonë ato, por kanë mirëkuptim, kur shohin se Serbia po kthehet në një qorr-sokak, jo vetëm për mjekët e rinj.

Problemi i emigrimit është bërë një plagë e ndjeshme për shoqërinë serbe, por ai nuk është i ri. Edhe në epokën e Titos, Jugosllavia e zgjidhte problemin e papunësisë përmes eksportimit të fuqisë punëtore. Në dekadat e fundit Serbia ka humbur afër 1 milion banorë. Për një vend me më pak se 7 milionë banorë, një problem jo i vogël. Çdo vit popullsia tkurret me 35.000 banorë, një rekord botëror.

"KUSH MBETET KËTU...?"

Jovana flet edhe për gjeneratën e saj, kur thotë se "me largimin tonë nga vendi, Serbia humbet, njerëzit e kualifikuar i kthejnë kurrrizin vendit. Në rrethin tim njoh një sërë miqsh që janë larguar. Jo vetëm të rinjtë. Nganjëherë janë familje, ose individë me 20 vite përvojë pune". Sipas një sondazhi të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, RÇ, që përmblodh 13 vende të Europës Juglindore, 32% e të anketuarve në vitin 2018 janë përgjigjur se luajnë me idenë e largimit nga vendi. Mësuesi i gjermanishtes, Filipi nuk mund të ankohet se nuk ka punë. Megjithatë, ai ka një shqetësim tjetër: "Nëse të gjithë largohen në Gjermani, kush do të kujdeset nga ana mjekësore për mua dhe fëmijët?"

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni *i* Ditës

Edi Rama nuk rrëzohet shpejt

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... sikur numërimi mbrapsht për Edi Ramën ka filluar dhe sikur ditët e tij janë të numëruara. Këtë version, që është shumë larg të vërtetës, e përhapin pak a shumë edhe varëtësit e tij duke përkundur idenë se e shtuna e ardhshme do të jetë ose dita e fundit në pushtet e kryeministrit, ose pika e kthesës, kur ai do të marrë përfundimisht të tatëpjetën.

Në fakt, nuk është aspak kështu dhe mbi të gjitha, këtë e di mirë edhe vetë Lulzim Basha.

Përndryshe, nëse regjimi oligarko-kriminal i Rilindjes do të përmbysë me një apo dy demonstrata, nuk ishte nevoja që opozita të braktiste parlamentin, të digjte mandatet, të planifikonte bojkotin e zgjedhjeve të ardhshme lokale dhe si përfundim daljen krejtësisht nga sistemi.

I gjithë ky përshkallëzim, i cili përbënte, fatkeqësisht, të vetmen rrugë për t'u përballur me një bandë që grabiti zgjedhjet për të plaçkitur Shqipërinë dhe vjedh vendin për të përparë votat, ishte përqafimi i një rruge të mundimshme.

Ai u ndërмор, së pari, për t'i ndërgjegjësuar edhe më shqiptarët se çfarë tip sundimtari po i qeveriste dhe për t'i lënë ata, të vetëm, përballë me portretin e tij, sa brutal aq edhe grotesk.

Ai u ndërмор, njëkohësisht edhe për të futur opozitën në një proces katarsisi, ku vetësakrifikimi dhe radikalizimi do të shërbenin si mjete për të prerë urat me mëkatet e së shkuarës.

Ai u ndërмор edhe për ta eksportuar krizën shqiptare nga diplomatët e lehtë apo konformistët të Tiranës, tek kancelaritë e tyre në qendër, ku e vetmja autokraci në qerthullin e BE-së zor se do të pranohet.

Të gjitha këto procese kërkojnë një kohë të gjatë precipitimi dhe reflektimi dhe çdo lloj tjetër qasjeje, për një shembje të shpejtë të Edi Ramës, nuk është asgjë më shumë sesa një gënjeshtër taktike për mitingun e radhës.

Por, përpos kësaj analize praktike për atë që do të ndodhë, ka edhe një problem teorik: a i intereson pjesës më të madhe të shqiptarëve një rrëzim i shpejtë i Edi Ramës? A u leverdis atyre (përveç katër - pesë njerëzve që duan t'i zënë karrigen) një rotacion i beftë, që historia jonë e shkurtër na ka mësuar se nuk pëll kurrë ndryshim? A përbën lehtësim për vendin heqja qafe e këtij njeriu që, me çdo ditë qëndrimi në pushtet, vetëm i bën dëm Shqipërisë?

Sado kontradiktore që të duket, përgjigja është: Jo.



Sepse Edi Rama nuk duhet thjeshtë të rrëzohet, ai duhet lënë të degradohet në pushtet.

Sado e madhe që të jetë kostoja ekonomike dhe njerëzore, Rilindja pas rilindjes duhet të vijë pasi gjithçka të ketë prekur fundin.

Po të shikohet vetëm ky muaj pas djegies së mandateve, sado që koha është e shkurtër, shenjat e para të degradimit janë tejet të prekshme.

Mjafton të vëzhgosh pasqyrat më të qarta të interesave të oligarkisë në këtë vend, dy TV e mëdha kombëtare, si e kanë çjerrë maskën dhe si janë vënë në shërbim të pushtetit.

Mjafton të dëgjosh kryeprokuroren e republikës, të

zgjedhur me votat e socialistëve, se si hakërrehet ndaj opozitës dhe mediave.

Mjafton të këqyrshë Policinë e Shtetit se si u vërsul fëmijëve dhe grave shtatzëna tek "Petro Nini", me mendësinë se kushdo që proteston në rrugë është armik i partisë.

Mjafton të ndjekësh në parlament deputetët e "opozitës së re", që nga njëra anë thotë se do të përfaqësojë elektoratin e tradhtuar nga Basha dhe Kryemadhi dhe nga ana tjetër voton sipas porosisve të Edi Ramës.

Të gjitha këto janë sinjale të qarta se imazhi i një vendi normal ka filluar të thërrmohet me shpejtësi.

Dhe ky proces duhet lënë të vazhdojë në rrjedhje të lirë. Sepse vetëm

kështu, falë këtij radikalizimi, kësaj vije të qartë ndarëse, të gjithë do të kuptojnë se cilët janë në anën e drejtë të barrikadës dhe cilët janë kameleonët që i përshtaten pushtetit të radhës.

Nëse Lulzim Basha e ka me tërë mend sloganin se nuk duhet rrëzuar vetëm Rama, por duhet shembur sistemi që e mban atë në këmbë, kjo nuk mund të bëhet as me një demonstratë, as me një puç palati. Ky është një proces që kërkon kohë. Kohë për ta lënë të telendiset deri në fund ai që kërkoi t'u hiqej shqiptarëve si nxënësi i Faik Beut apo i Nollit, por kohë edhe për vetë opozitën, të cilën, dalja e ngadalitë nga sistemi do ta zhveshë nga lidhjet okulte me ingranazhet e tij (pronarë mediash, oligarkë, banditë, që sa më shumë muaj të kalojnë, aq më tepër do afrohen me pushtetin).

Në këtë kuptim, sot armiku më i madh i gjithë kundërshtarëve të Ramës nuk është ai vetë, por tentimi për ta rrëzuar shpejt atë. Paradoksalisht, sa më i gjatë të jetë lëngimi i përbashkët me sëmundjen e tij, aq më të forta do të jenë antikorpët, që nuk do të lejojnë më ringjalljen e kësaj flame.

HOROSKOPI

DASHI

Për të lindurit e kësaj shenje, e premija do të përbëhet nga udhëtime të shkurtra, takime miqësore dhe flirtime. Është dita e duhur për të gjithë ata që janë në kërkim të dashurisë. Rekomandohet ta kaloni ditën me të afërmit dhe bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.

DEMI

Ka gjasa të përballemi me incidente të papritura. Situata të tilla mund t'ju shkaktojnë stres. Në mbrëmje mund të zbuloni një sekret në familje dhe mund të merrni një vendim të rëndësishëm. Jepini mbështetjeje dhe duhur partnerit/partneres suaj.

BINJAKET

Shumë Binjakë do të kalojnë një ditë mjaft të këndshme. Në punë nuk do të hasni probleme. Mos u kushtoni vëmendje kolegëve të pakujdesshëm, ose provokimeve të partnerit tuaj. Një ngjarje spontane do t'ju emocionojë pafund dhe do t'ju bëjë të mendoni pozitivisht.

GAFORJA

Mos u përpini të gjeni fajtorin pas një problemi që mund të krijohet në punë. Bëni mirë të mbani veten nën kontroll dhe të mendoni me qetësi rreth një zgjidhjeje. Ka gjasa që partneri/partnerja juaj të jetë shqetësuar për shkak të indiferencës suaj.

LUANI

Do të jeni mjaft energjikë gjatë kësaj të premtjeje. Do të dëshironi të kapri majat në kamerën tuaj. Njëkohësisht do të dëshironi t'i pushtoni zemrën partnerit/partneres suaj dhe të sulmoni konkurrentët. Do të kaloni një mbrëmje mjaft të këndshme nën shoqëri të miqve tuaj.

VIRGJERESHA

Për Virgjreshat, kjo ditë ka shumë të ngjarë të shkojë sipas rutinës së dikujt tjetër. Ka gjasa të përfshihen në një detyrë në terren ose në një projekt që kërkon me doemos bashkëpunimin e një kolegut tuaj.

PESHORJA

Mos u mbështetni te një person i caktuar këtë të premtje, pasi mund t'ju zhgënjë në momentin më të papërshtatshëm. Gjithashtu, mund të bëjë një sjellje joprofesionale, çfarë mund ta përkeqësojë edhe më tej situatën. Nuk është dita e duhur për njohje të reja.

AKREPI

Detyra kryesore e Akrepave sot është gjetja e një stili të ri. Është e rëndësishme që të përcaktoni qëllimin tuaj kryesor në jetë. Eksperimentoni, por mos e teproni, pasi mund t'ju kthehet në një përvojë të sikletshme.

SHIGJETARI

Do të përjetoni disa momente pozitive gjatë ditës së sotme. Do të jeni në qendër të vëmendjes së seksit të kundërt. Do të tentoni për ngritje në detyrë dhe ekziston mundësia që të tentativa juaj të rezultojë e suksesshme.

BRICJAPI

Mund bëni disa blerje të rëndësishme dhe të krijoni njohje të dobishme. Bëni kujdes me sjelljen ndaj kujdo që mund të takoni. Tregohuni të guximshëm dhe provoni gjëra të reja. Ata që dyshojnë tek partneri/partnerja mund ta vënë dashurinë në provë.

UJORI

15 marsi mund të jetë mjaft produktiv. Është e nevojshme që të tregoni takt në bisedat me të afërmit dhe kolegët tuaj. Një prej tyre mund të jetë mbështetja juaj më e madhe për të arritur planin tuaj.

PESHQIT

Peshqit mund të mëzërin nga monotonia e ditës së sotme. Do të jetë një ditë rutinë në punë, por në jetën personale do të përballemi me shqetësime. Mos u bëni pesimist, por përpini të mbusheni me energji për të kaluar gjithçka.

REBUS TE KORÇARËT

Skënderbeu shkon në sfidën e fundjavës ndaj Kukësit i relaksuar, pasi korçarët kanë siguruar biletën e gjysmëfinaleve të Kupës së Shqipërisë pa luajtur duke qenë se Kamza, kundërshtari i tyre në këtë fazë u përjashtua nga gara. Në një situatë të tillë kampionia e vendit shihet si më e avantazhuar ndaj nënkampiones, por në fakt një situatë e tillë konsiderohet thikë me dy presa.



Nëse është e vërtetë që Skënderbeu është më i kthjellët dhe i relaksuar, mos

Shehi në dilemë për aktivizimin e Bregut

luajtja në Kupë bën që skuadra të ketë humbur ritmin, pasi stërvitja dhe miqësoret nuk kanë të njëjtin densitet si me ndeshjet zyrtare. I vetmi avantazh në këtë shtyrje të kampionatit është fakti që lojtarë si Dejvi Bregu kanë mundësi të rikthehen më shpejt në fushë duke llogaritur me sfidat e luajtura, pasi

është shtyrë kampionati me njëjavë. Ndërkohë stafi teknik e sheh si negative këtë ndalesë të garës apo mos luajtjen në Kupë, pasi lojtarët jo vetëm humbasin ritmin por u ndalën në një moment të mirë, pas atij barazimi 2-2 me përmbysje në Niko Dovana ndaj Teutës. Pikërisht nga ajo ndeshje Skënderbeu shpre-

son rikthimin tek rezultatet pozitive për t'iu rikthyer pretendimeve që për momentin mbetet zona europiane. Diferenca me Laçin e vendit të 4-t është vetëm dy pikë ndërsa Teuta e vendit të tretë gjendet 6 pikë përpara. Deri në fund janë edhe 12 javë kampionat ndërkohë që këtë fazë të tretë skuadra kampione e mbyll në një fitore të siguruar në tavolinë, pikërisht ndaj Kamzës së skuadërimit nga gara.

BEFASIA

Evra publikon mesazhet, Ronaldo kishte parashikuar përmbysjen

Kristiano Ronaldo shpeshherë gjatë karrierës së tij e ka treguar se nuk është nga ata futbollistë që dorëzohen. Portugeziteti i pëlqen të luftojë deri në fund, ndërsa me vullnetin e tij ia ka dalë të shndërrohet në atë çfarë përfaqëson sot në elitën e futbollit botëror. Kjo vërtetohet më së miri edhe në ndeshjen e fundit të Ronaldos, ku luzitani nuk bëri hapa pas, por mori përdore Juventusin pas disfatës 2-0 në ndeshjen e parë ndaj Atletiko Madrid. 34-vjeçari gjithmonë kishte besuar te përmbysja dhe këtë e vërtetojnë mesazhet e shkëmbyera me ish-futbollistin e Mançester Junajtid dhe Juventus, Patris Evra 5 ditë para ndeshjes. Ka qenë francezi ai i cili i ka publikuar bisedat në të cilat Ronaldo shprehej i sigurt te përmbysja. "Do të kalojmë miku im, është e sigurt, në shtëpi do t'i shkatërojmë", shkruante i vendosur Ronaldo. Ndërkohë që Evra i përgjigjej, "Kështu po, tekta të enjten, një ditë përpara ndeshjes me Turqinë, në stadiumin "Loro Boriçi", në orën 17:00, do të zhvillohet konferenca për shtyp me trajnerin e ekipit kombëtar dhe kapitenin.

Ajeti rigjen Kombëtaren, sikundër dhe Aliji, ndërsa kanë mbetur jashtë Lenjani, Bare apo Ndoj

Kristian Panuçi habit me listën, rikthime e përjashtime të bujshme
Risia e vetme është emri i mesfushorit Kristi Qose



Jeton Selimi

Shqipëria provoi për herë të parë ndjesinë e përfaqësimit në një turne madhor në "Euro 2016", një arritje fantastike, një ëndërr e bërë realitet. Pasi arkivoi atë sukses të jashtëzakonshëm nën drejtimin e De Biazit, Shqipëria kërkon sërish të përsërisë historinë, këtë herë nën drejtimin e Kristian Panuçit. Më 22 mars nis zyrtarisht aventura e kuqezive në European tek-sa presin Turqinë në "Loro Boriçi", një sfidë shumë e rëndësishme për rugëtimin e tyre. Pasi i dha fund zërave që e shihnin shpesh në stolin e çdo ekipi italian që ishte pa trajner, mbi të gjitha në stolin e Romës, Kristian Panuçi është i fokusuar totalisht te Shqipëria dhe kualifikueset. Këtë të enjte trajneri i Kombëtares publikoi listën e parë me lojtarët që ka grumbulluar në dy takimet e para,

Et'hem	BERISHA
Alban	HOXHA
Thomas	STRAKOSHA
Arlind	AJETI
Naser	ALIJI
Ivan	BALLIU
Egzon	BINAKU
Berati	DJIMSITI
Elseid	HYSAJ
Ardian	ISMAJLI
Enea	MIHAJ
Frederic	VESELI
Amir	ABRASHI
Migjen	BASHA
Eray	KACE
Andi	LILA
Leidian	MEMUSHAJ
Krist	QOSE
Taulant	XHAKA
Kristal	ABAZAJ
Bekim	BALAJ

kundër Turqisë dhe Andorës. Nga rikthehet e bujshme tek risitë, në listën e Panuçit gjejmë gjithçka. Trajneri i kombëtares, nga

kampionati ynë nuk ka preferuar asnjë futbollist përveç Alban Hoxhës, portierit të Partizanit. Ndërkohë është rikthyer Sadiku dhe Abrashi pas dëmtimeve të gjata. Një vend edhe për Kristal Abazajn që ka rigjetur formën e tij pas huazimit te Osijeku. Gjithashtu, ka merituar një ftesë edhe mesfushori i Ruzemberok në Slloveni, Kristi Qose. Nuk janë preferuar lojtarë si Manaj, Bare, Lenjani, Lullaku dhe Sabien Lilaj. Ndërkohë mungojnë me "arsye" Roshi, i dëmtuar dhe Mavraj i pezulluar me 3 ndeshje. Trajneri Panuçi do të dalë përpara mediave në një

konferencë për shtyp ditën e diel, në orën 11:00, në selinë e FSHF-së, siç edhe është parashikuar. Grumbullimi i ekipit kombëtar do të nisë ditën e diel, ndërkohë që seanca e parë stërvitore do të jetë në orën 15:00. Ndërkohë, sipas programit mediatik për ekipin kombëtar A, për tre ditë me radhë, të hënë, të martën dhe të mërkurën, në orën 13.30 do të jenë përpara mediave dy futbollistë të ekipit kombëtar, tekta të enjten, një ditë përpara ndeshjes me Turqinë, në stadiumin "Loro Boriçi", në orën 17:00, do të zhvillohet konferenca për shtyp me trajnerin e ekipit kombëtar dhe kapitenin.

"TRADHTARI"

Zhëgjnjimi i parë për Durmishjan, Greqia e lë jashtë

Gjatë javëve të fundit, zgjedhja e Durmishajt për të përfaqësuar kombëtaren greke dhe jo atë shqiptare ishte lajmi që ka bërë më shumë bujë. Kjo zgjedhje nuk është marrë aspak mirë nga shqiptarët, të cilët e kanë quajtur tradhtar. Por gjithë kjo zhurmë, duket se nuk i ka sjellë fat Durmishajt, për faktin se ai nuk është grumbulluar nga Kombëtarja greke për dy ndeshjet, që do të luajë këtë muaj kundër Lihteshtajnit dhe Bosnjes, në kuadër të kualifikuesve të Europianit 2020. Federata greke nuk e ka marrë dritën jeshile për të grumbulluar Durmishajn dhe pritja e tij do të shtyhet deri në qershor, ku me shumë gjasa do të luajë kundër Italisë dhe Armenisë.



VLERËSIMI I PORTUGEZIT

Murinjo: Zidan, perfekt për Real Madridin


Për disa javësh u përfol si trajneri i ri i Real Madridit, një rikthim i tij që madje u cilësua i bujshëm. Por në fund, në krye të "Los Blancos" u realizua Zidane-bis dhe ai, momentalisht, ka mbetur me duar bosh dhe me kontratën milionere në tv. Do të duhen ende disa muaj për ta parë Zhoze Murinjon në krye të një stoli, por ndërkohë, ai ka dashur të flasë për rikthimin e Zizus. "Mendoj se është perfekt për Realin. Ka bërë gjëra fantastike vitet e fundit dhe kjo është një mundësi e madhe për të treguar sesa i zoti është, sepse tani do të ketë një projekt të ri. Kjo është fantastike dhe i uroj fat", thotë Murinjo, që më pas shton: "Nuk jam aspak i zhëgjnyer. Kurrë nuk kam thënë se do të më pëlqente të rikthehesha aty. Them vetëm që Zidan është perfekt për Realin, unë kështu e mendoj. Nuk kam folur me asnjë përfaqësues të Realit."




Do zhvillohet një herë në 4 vjet

FIFA do t'i japë Kupës së Botës për klube, UEFA kundër

Lantumirë Botërori i Klubeve, tashmë do të kemi një kompeticion të ri, të quajtur Kupa e Botës për klube dhe njëjtë si Botërori i madh, do të zhvillohet një herë në katër vjet. Edicioni i parë do të organizohet nga 17 qershori deri më 4 korrik të vitit 2021, ndërsa vendi ku do të zhvillohet turneu nuk është përcaktuar ende. FIFA do ta miratojnë veprimtarinë e re sot në mbledhjen e radhës që do të mbajë në Majemi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Botërori i Klubeve që zhvillohet aktualisht në muajin dhjetor do të zhduket, ndërsa në turneu e ri do të marrin pjesë 24 klube. UEFA është kundër këtij hapi të FIFA-s, çka ka sjellë dhe përplasjen mes institucioneve, por ka mjaft klube, sikundër Barcelona, që janë pro këtij projekti.



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Gjëja e latinëve.
 - Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
 - Është fjala e për e foshnjës.
 - Ministri Ekonomisë e Pune
 - Marubi i fotografisë.
 - Bel i Mappussant.
 - Bëhet duke tregtuar objekte të shenjtja.
 - Derek aktore.
 - Gjysmë totale.
 - Është art i të folurit
 - Një patriark biblik.
 - Mund të jenë zemërkau të tilla.
 - Janë dëshmorë të kishës.
 - Është lloj papagalli.
 - Është lloj papagalli.
 - Qerre pa qe.
 - Ekstremit në numërim.
 - Është bodrumi.

- Steiger aktor.
- Inicialet e Delon.
- Është edhe ai Me Gropa.
- Një mund të jetë autonom.
- Në krye të evidencës.
- Edgar Allan Poe.
- Ekstremit në litar.
- Giorgio i modës.
- Janë malet me Akonkagua.
- Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

- Novarro që qe aktor.
- Kusturica regjisor.
- Është e jashtëzakonshme.
- Inicialet e Kazan.
- Ishte qyteti i 100 portave.
- Pinci i Dy herë mat.
- Janë të mirat që prodhohen.
- Është ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
- Një markë celulari.
- Ushtrohej nga filibustierët.
- Një përsiatje.
- Agjenci Informative Tiranë.
- Një brejtës pylli.
- Një Gjon që qe aktor i yni.
- Titulli i Byron.
- Në radhë të parë.
- Emri i Amundsen.
- Moore aktore.
- Pishtarë pa pishë.
- Gjysmë vatani.
- Rruga e Molnar.
- Një fazë gjumi.
- Inicialet e Redford.
- Në krye të notarëve.
- Inicialet e Reitman.
- Unë dhe ti.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Nuk kalohet nga mbetësi.
- U printe gladiatorëve
- Bëhet duke shkuar lart e më lart
- Tatum që qe pianist.
- Një që lufton për para
- Mund të bëhet me safari
- Breshkat luftarake të kartonave
- Ngjitet kur nuk ngjet
- Në mes të rrugës
- Sporti me rikisha
- U shkrua nga Hesiodi
- Një sferë për model
- Mbyllin një sirtar
- Makina Tipo
- Inicialet e Bean, aktor
- Nino, kompozitor i famshëm italian
- Ramiro pa zë.
- Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


- E bukura e belle epoque.
- Qe mbreti i elfëve
- Farrow, aktore
- Hagen rockstar
- Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
- Në fund majtas
- Mund të preken nga morbusi i Basedow
- Ad... për të ngarkuarin me punë
- Loach regjisor
- Qytet zviceran
- Në krye të kryesisë
- Ughi violinist
- Carlos që qe pilot i Formula 1
- Ekstremit në muzg
- Inicialet e Steinbeck
- Gruda, "Njeriu me top"
- Është X ajo e sulmit
- Paradhoma e parajasës
- Është edhe ai i luftës
- Janë edhe ato të cirkut
- Mbarojnë fare
- Inicialet e Reed, aktor
- Të parët në sondazh
- Është taksa
- Një mund të jetë emërore
- Një pjesë e marrëzisë
- Gjysmë mimoze
- Hundë kur s'jam unë
- Skuadër greke
- Lemper, këngëtare gjermane
- Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



SUDOK

			3	1			8			
										1
	3	2				9				7
2		5		4						
							8	9		
			1							
3										
		7	6		8					3
9								1	4	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	3	7	6	2	8	5	4	1		
5	8	1	9	3	4	6	2	7		
4	2	6	1	7	5	8	9	3		
1	4	2	7	5	6	9	3	8		
6	9	5	2	8	3	1	7	4		
3	7	8	4	9	1	2	6	5		
2	5	9	3	1	7	4	8	6		
7	1	4	8	6	9	3	5	2		
8	6	3	5	4	2	7	1	9		

Argëtim filozofik

- Nëse gruaja nuk di çfarë të thotë, e vetmja gjë e sigurt është se ajo nuk do të heshti.
- Është normale, të gjithë bëhen filozofë kur nuk është problemi i tyre.
- Mos prisni askënd në jetën tuaj ... shkoni përpara ... dhe ata që duan, do t'ju arrijnë !!!
- ...Dhe vjen një ditë kur ti e kupton se "çdo gjë" ishte "asgjë" vetëm një zhgënjim !!!
- Është e vështirë të besohet se dikush po thotë të vërtetën, kur e dini se në vendin e tij do të gënjëni.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

B	A	S	T	E	T	P	A	P	A	M	I	K	E	K	M	S	E				
U	R	A	T	U	R	H	P	A	E	K	A	R	O	M	A	K	E	T			
S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T	P	A	S	A	N	I	K	T	S	
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R	E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T	R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
S	A	L	I	R	A	M	A	E	I	T	R	B	L	A	K	E	L				
G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R	M	I	A	R	E	D	E	K	I		
A	R	E	S	A	O	E	N	E	E	M	E	T	A	L	E	I	S				
Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T	T	E	K	E	M	K	U	M	T		
I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S	M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

Thënie të mençura

- Çdo herë që përpiqem të ndryshoj përfundoj të jem vetvetja!!!
- Në fund, nuk do të kujtojmë fjalët e armiqve tanë, por heshjen e miqve tanë.
- Kush kontrollon të shkuarën kontrollon të ardhmen. Kushdo që kontrollon të tashmen kontrollon të shkuarën.
- Veshët besojnë më vështirë se sytë.
- Tragjedia në jetë është se po bëhemi pleq shumë shpejt dhe të mençur shumë vonë.
- Atje ku flasin shumë, heshjtja bëhet virtyt.

